Dr. Majlinda Hala

Violeta Shamku

Libër për mësuesin
ART MUZIKOR 7

BOTIME

pegi

BOTIME

Drejtoi botimin: Valmira MUSHI
Recensentë të MASHT-së: Prof. asoc. Merita JUNIKU,
Genita HOXHA, Shaip GUGJULI
Redaktore letrare: Eni MYRTOLLARI
Paraqitja grafike: Gazmir MYTEBERI
Kopertina: Enkeleda REXHA
Shtypi: Shtypshkronja Pegi, Lundër, Tiranë
ISBN: 978-9951-786-01-0

© Botime Pegi sh.p.k, dega në Kosovë, korrik 2019
Të gjitha të drejtat për këtë botim në gjuhën shqipe janë tërësisht
të zotëruara nga Botime Pegi sh.p.k. Ndalohet çdo riprodhim, fotokopjim,
përshtatje, shfrytëzim ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, pjesërisht
ose tërësisht, pa miratimin paraprak nga botuesi.

Botime Pegi: tel: +355/ 042 468 833; cel: +355/ 069 40 075 02;
e-mail: botimepegi@botimepegi.al; web: www.botimepegi.al
Sektori i shpërndarjes: cel: +355/ 069 20 267 73; 069 60 778 14;
e-mail: marketing@botimepegi.al
Shtypshkronja Pegi: cel: +355/ 069 40 075 01;
e-mail: shtypshkronjapegi@yahoo.com

Përmbajtje

HYRJE 5

TEKNIKA TË MËSIMDHËNIES 7

PLANI VJETOR 12

PERIUDHA I: SHTATOR-DHJETOR 16

PERIUDHA II: JANAR-MARS 23

PERIUDHA III: PRILL-QERSHOR 30

MODELE TË PLANIFIKIMEVE DITORE 33

I. HYRJE

Muzika kontribuon në zhvillimin fizik, emocional, intelektual, social dhe estetik të fëmijës, pra në formimin e gjithanshëm e posaçërisht në formimin kulturor të fëmijëve duke e pasuruar botën e tyre shpirtërore, identitetin dhe personalitetin. Me gjuhën universale të cilën e kuptojnë të gjithë njerëzit pa dallim race, gjinie, e moshe, muzika u ndihmon nxënësve të kuptojnë dukuritë dhe proceset muzikore për t'i shfrytëzuar ato për komunikim dhe shprehje artistike në kontekste të ndryshme. Si aktivitet shoqëror që në zanafillën e paraqitjes së saj, muzika është medium që mundëson aktivitete të përbashkëta grupore ku kërkohet bashkëpunimi në realizimin e këngëve, pjesëve muzikore me instrumente etj., duke iu mundësuar nxënësve që të zhvillojnë shkathtësitë e ndryshme muzikore krahas zhvillimit të kompetencave të tjera të përgjithshme.

Lënda Art muzikor në klasën e shtatë synon të:

- identifikojë prirjet dhe zhvillojë shkathtësitë muzikore të nxënësve sipas interesimit dhe dispozitave individuale-veshin muzikor, këndimin, luajtjen në instrumente etj.;
- pasurojë "fjalorin" e termeve dhe të koncepteve bazike të gjuhës muzikore për të mundësuar komunikimin artistik dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive të nxënësve për ritmin, melodinë, harmoninë, format muzikore, instrumentet, institucionet, krijuesit dhe performuesit;
- aftësojë nxënësit që të familjarizohen me dëgjimin aktiv muzikor dhe të çmojnë e vlerësojnë krijimtarinë muzikore (kombëtare dhe botërore) të stileve dhe zhanreve të ndryshme muzikore;
- nxis nxënësit që të provojnë aftësitë e tyre krijuese muzikore;
- identifikojnë krijuesit dhe performuesit, institucionet dhe ngjarjet e rëndësishme muzikore.

II. STILET E TË NXËNIT, PJESË E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TËARTIT MUZIKOR, KLASA 7

Planifikimi i punës mësimore dhe procesi i mësimdhënies është një fazë e cila kërkon t'i japë njohuritë e duhura nxënësit, të nxisë nevojat e tyre, interesat dhe mënyrat e tyre të të mësuarit. Procesi mësimor do të ketë rezultate pikërisht nëse nxënësit janë të nxitur për të nxënë dhe ku secili nxënës mëson sipas një mënyre të caktuar apo të njohur në literaturën pedagogjike si *stile të të nxënit.* Disa nxënës mësojnë përmes *perceptimit,* të tjerë mësojnë duke *analizuar apo reflektuar,* disa përmes *të parit dhe të dëgjuarit,* disa mësojnë vetëm, të tjerë mësojnë në grupe, disa mësojnë në tërësi përmbajtjen mësimore, ndërsa të tjerë e ndajnë atë në pjesë më të vogla logjike.

Krahas këtyre përcaktimeve të të nxënit janë mësimdhënësit të cilët gjatë përdorimit të strategjive dhe metodave në procesin mësimor, nxjerrin në pah artin dhe mjeshtërinë e tyre, por edhe vënë në zbatim përmes stileve të të nxënit këto metoda. Mësimdhënësit në mësimin e muzikës duhet të përdorin më shumë demonstrimin, bisedën, lojën me role, reflektimin, diskutimet. Për të arritur suksese në procesin mësimor duhet patjetër që mësimdhënësi t'i zbatojë stilet e të nxënit, duke njohur më parë mënyrat se si mësojnë nxënësit, pikëmbështetje për planifikimin e punës mësimore, përputhshmërisë së stileve të të nxënit dhe përdorimit të metodave apo teknikave të mësimdhënies në varësi të stileve të përdorura. Stilet e të nxënit, nëpërmjet metodave dhe teknikave të mësimdhënies përmbush detyra të rëndësishme të mësimdhënies.

II.1. Stili i të nxënit pamor është kur nxënësi e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së të parit. Në këtë rast mësimi konkretizohet duke përdorur mjete mësimore si: *fotografi, grafikë, piktura, ngjyra, ilustrime, instrumente muzikore, dvd (ku ndërthuret edhe stilin dëgjimor).* Të nxënit përmes të parit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi/ja ku kërkohet përqendrimi i nxënësve në:

- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të memorizuar apo për të kujtuar një ndodhi, një ngjarje, një situatë të caktuar në kontekstin e temës mësimore.
- Vëzhgimin e materialeve të vendosura për të nxitur diskutimin apo për të verifikuar njohuritë e marra më parë.

II.2. Stili i të nxënit dëgjimor është kur nxënësi/ja e përvetëson përmbajtjen mësimore me anën e shqisës së dëgjimit. Këta nxënës përvetësojnë më mirë dhe më lehtë njohuritë nëpërmjet *dëgjimeve të fragmenteve muzikore, improvizime përmes lëvizjeve trupore, krijimeve nëpërmjet përjetimit nga dëgjimi i muzikës* ku bëhen krijime të ndryshme dhe diskutohet për to. Të nxënit përmes dëgjimit zhvillohet nga veprimtari të organizuara nga mësuesi ku kërkohet përfshirja e nxënësve në:

- dëgjimin e muzikës dhe edukimin e përqendrimit për të dëgjuar muzikë;
- dëgjimin e muzikës dhe mësimin e këngëve për fëmijë apo këngëve lojë dhe diskutimin në lidhje me tekstin dhe melodinë e këngës;
- dëgjimin e muzikës dhe improvizimin përmes lëvizjeve trupore apo vizatimit në kontekstin e temës mësimore;
- dëgjimin e muzikës dhe nxitjen e bisedave apo diskutime në lidhje me fragmentin muzikor që dëgjon;
- dëgjimin e muzikës dhe prezantimin e krijimeve të ndryshme të krijuara nën përjetimin e muzikës.

II.3. Stili i të nxënit kinestetik është kur nxënësi/ja përvetëson përmbajtjet mësimore në mënyrë aktive, duke *vepruar, luajtur, shkruar, vizatuar* etj. Këta nxënës janë më të suksesshëm nëse:

- e prekin dhe e ndjejnë përmbajtjen mësimore;
- i përdorin pjesët trupore dhe ndjenjat;
- përdorin gjuhën e ndjenjave.

Përmes stileve të të nxënit nxënësit zhvillojnë prirje dhe shkathtësi të ndryshme p.sh.: bashkëveprimi në lojëra të ndryshme muzikore, apo aktivitete në grup, performime muzikore dhe kërcimore në shfaqjet skenike, kërcim apo teatër, biseda në lidhje me temën e mësimit etj.

Të tria këto stile harmonizohen dhe ndihmojnë çdo mësimdhënës të planifikojë veprimtari të larmishme mësimore muzikore, duke i përdorur ato përmes teknikave dhe metodave të mësimdhënies.

Disa veprimtari muzikore që kanë të bëjnë me procesin e mësimit të muzikës ku ndihmojnë dhe stilet e të nxënit janë:

1) Mësimi i këngëve bën pjesë në stilin e <u>*të nxënit pamor, dëgjimor por edhe kinestetik,*</u> sepse këngët duhet:

- të mësohen;
- të këndohen duke respektuar të gjitha kërkesat e këndimit dhe repertori i sugjeruar për t'u mësuar;
- të shoqërohet edhe me instrumente muzikore popullore, por edhe Orf;
- të shoqërohet me lëvizje trupore.

2) Në fushën e *lojës me instrumente muzikore* mësuesi bashkëpunon dhe synon vënien në përdorim të funksionit të muskujve të duarve gjatë luajtjes në instrument muzikor duke i angazhuar nxënësit në përdorimin e instrumenteve muzikore popullore shqiptare të ngjashme edhe me instrumentet ORF për *shoqërimin e këngëve* që këndojnë.

3) Dëgjimi muzikor bën pjesë në stilin e <u>*të nxënit pamor, dëgjimor por edhe kinestetik,*</u> sepse edukon përqendrimin dhe vëmendjen ndaj dëgjimit të muzikës, dhe memorizimin e njohurive muzikore në përjetimin e muzikës përmes veprave muzikore shqiptare dhe ato botërore.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies për të përmbushur stilet e të nxënit në muzikë janë të shumta dhe i japin mundësinë çdo nxënësi të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor dhe artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të muzikës do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.

Metodat dhe teknikat e mësimdhënies për të përmbushur stilet e të nxënit në muzikë janë të shumta, dhe i japin mundësinë çdo nxënësi të shfaqë dhe të zhvillojë potencialin muzikor dhe artistik, që zotëron brenda vetes. Organizimi i mirë i procesit të mësimit të muzikës do të thotë që nxënësit të vendosen në situata konkrete dhe praktike, ku ata zbulojnë, kuptojnë, krijojnë dhe performojnë muzikën nëpërmjet përdorimit të mjeteve të larmishme artistike.

Disa teknika shumë efikase në orën e muzikës janë *Brainstorming, Kllaster, Harta e të pyeturit, Diagrami i Venit, DDM, Harta e koncepteve, Kubimi, INSERT etj.*

III. TEKNIKA TË MËSIMDHËNIES



Në stilin e të nxënit pamor dhe dëgjimor veçojmë edhe teknikën e kllasterit. **Kllasteri**, ose grupimi i mendimeve që, ndonjëherë, në literaturë emërtohet "harta e mendimeve", është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të mësuarit, duke sjellë nga kujtesa njohuritë muzikore që ata kanë dhe plotësuar ato më tej gjatë fazave të tjera të orës mësimore.

Rrjeti i diskutimit është një teknikë e mësimdhënies, gjatë së cilës bëhet organizimi grafik i informacionit. Kjo teknikë i bën nxënësit të jenë të vëmendshëm ndaj dëgjimit të veprave muzikore, për të kuptuar përmbajtjen muzikore të veprave dhe krahasuar ato. Përdoret në fazën e realizimit të kuptimit dhe të reflektimit. Sipas kësaj teknike, klasa ndahet në dy grupe ("Pro" dhe "Kundër"). Grupet mund të jenë edhe mbi 20 vetë. Diskutimi midis grupeve vazhdon 15-25', sipas temës dhe mund të realizohet me nxënës të çdo moshe.

Brainstorming, është një veprimtari që bën pjesë në **stilin pamor** por edhe **dëgjimor**, duke iu përshtatur lëndës së muzikës sepse nëpërmjet vendosjes së një fjale kryesore apo fragmenti muzikor për dëgjim Cd, shërben si fillimi i një diskutimi në mësim për një problem të caktuar, i cili më pas vazhdon me metoda e teknika të tjera.

Qëllimi i përdorimit të Brainstorming-ut është të vërë në dukje sa më shumë ide, zgjidhje ose komente për një problem të dhënë. Brainstorming-u përdoret për të shprehur ide të reja me të gjithë klasën ose me një grup nxënësish dhe karakterizohet nga një lojë me përmasa të gjera dhe nga një intensitet i të shprehurit të larmishëm për gjëra të njohura. *P.sh. shkruhet në dërrasë të zezë fjala "Muzika popullore shqiptare", ose vendosjen e një muzike popullore mjaft të njohur për dëgjim ku nxënësve u kërkohet të flasin rreth asaj që dinë mbi muzikën popullore shqiptare, duke sjellë informacion mbi muzikën e krahinës së vet.*

Kjo teknikë kërkon të mbahet parasysh:

- Asnjë prej zgjidhjeve e ideve të mos kritikohet.
- Të nxiten nxënësit të shprehin ide.
- Diskutimi të zhvillohet për gjëra të njohura.
- Të aktivizohen edhe nxënës të ndrojtur.
- Të shërbejë si nxehje e trurit.



Kubimi është një teknikë që mund të bëjë pjesë në **stilin dëgjimor** sepse përmes vendosjes së një vepre dëgjimore shqiptare, ndihmon shqyrtimin e veprës nga këndvështrime të ndryshme, për shkak të përjetimit emocional që është i ndryshëm te gjithsecili. Ai përfshin përdorimin e një kubi me lëvizje të shpejta për të menduarin, të shkruarin në secilën faqe të kubit. Mund të ndërtohet duke mbuluar një kuti të vogël me letër. Në secilën faqe të kubit shkruhen 6 kërkesa të shkurtra: *Përshkruaje, krahasoje, shoqëroje, analizoje, argumentoje (pro ose kundër)* p.sh.:

- vepër muzikore, këngën, muzikën popullore, dy kompozitorë, ku nxënësit udhëzohen të mendojnë për t'u dhënë përgjigje pyetjeve të mësuesit dhe ta përshkruajnë atë: (forma muzikore, karakteri i veprës, subjekti që trajton vepra etj.).

Tabela e koncepteve është një teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor**, një teknikë racionale për të organizuar informacionin muzikor përmes dëgjimit dhe krahasimit të disa veprave muzikore. Përdoret veçanërisht kur jepen njëkohësisht më shumë se një koncept a dukuri. Ndihmon së tepërmi të kuptuarit, përmes strukturimit të materialit, pas leximit dhe në realizmin e skemave të qarta, që sigurojnë qëndrueshmërinë e dijeve. Kjo teknikë përdoret me sukses në fazën e realizimit të kuptimit dhe reflektimit. Tabela e koncepteve hartohet duke renditur konceptet apo njohuritë muzikore, që duhet të krahasohen dhe në kolona renditen tiparet apo karakteristikat mbi bazën e të cilave bëhet ky krahasimi i veprave muzikore.



TIPARE DALLUESE	TË PËRBASHKËTAT	TIPARE DALLUESE
○ _____ ○ _____ ○ _____	○ _____ ○ _____ ○ _____	○ _____ ○ _____ ○ _____

Diagama e Venit është teknikë që bën pjesë në **stilin dëgjimor** më anë të së cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve muzikore, formave muzikore, ngjarjeve muzikore, kompozitorëve të ndryshëm, 2 periudhave muzikore etj. Diagrami i Venit ndërtohet me prerjen e dy a më shumë rrathëve. Përdoret kryesisht gjatë fazës së reflektimit, pothuajse në çdo orë mësimi. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta dhe veçori dalluese në varësi të specifikave të temës së mësimit, si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.

Harta e të pyeturit është teknikë që i përket **stilit pamor dhe dëgjimor:**



është një skicë që shfaq idetë e rëndësishme të mësimit, të vendosura në një renditje logjike në trajtën e një skeme racionale pyetjesh, që lexohen dhe kuptohen me lehtësi nga nxënësit e cila shoqërohet me fragmente të ndryshme muzikore.

Përparësitë:

- *Hap rrugën për diskutim.*
- *Ndihmon nxënësit për të zhvilluar aftësi më të mëdha të të menduarit.*
- *Tërheq nxënësit në punët e pavarura.*
- *Rrit rolin e nxënësve në mësim.*
- *Nxit të menduarit logjik.*
- *Nxit dhe tërheq nxënësit pasivë.*

Si të krijojmë një hartë të pyeturi? Për të përpiluar një hartë të pyeturi, mund të ndiqet kjo rregullsi:

- Shkruhet tema e mësimit që do të shpjegohet në qendër të tabelës.
- Pas kësaj vizatohet harta e të pyeturit, në të cilën pas pyetjeve kyçe, gjenden të lidhura edhe pyetje të tjera që zgjerojnë hartën.

Të mësuarit me projekte (Projekti)

- Projekti kurrikular është strategji e të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin

përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale. Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK, të sipërmarrjes etj.

- Projekti kurrikular në lëndën e muzikës është **rubrikë e detyruar e portofolit të të nxënit.**
- Projekti kurrikular **nuk** duhet të përmbajë njohuri të reja.
- Zbatimi i një projekti në lëndën e muzikës kërkon më shumë se një orë mësimore.
- Projekti kurrikular **mund** të jetë i shtrirë **përgjatë gjithë vitit shkollor**, pra në të tri periudhat, por mund të jetë i shtrirë dhe **vetëm brenda një periudhe**. Sido që të jetë shtrirja e projektit, ai ka vlerësimin e tij brenda vlerësimit të portofolit. Mësuesi që kur planifikon projektin duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit përgjatë zhvillimit të tij.

IV. MATERIALE DHE BURIME MËSIMORE

Gjatë mësimit të muzikës për realizimin e kompetencave, mësimdhënësi përdor mjete didaktike dhe burime, të cilat nxënësi/ja i prek, i shikon, i përdor, i dëgjon etj. Ai përdor mjete vizuale, teknologji të nevojshme, jep ndihma të veçanta, përshtat shembuj të ndryshëm, krijon mjedisin e përshtatshëm për aktivitete. Teknologjia ka një ndikim të madh në muzikë duke ndihmuar nxënësit/et të eksplorojnë këngë matematikë të ndryshme, për të rinj, arie, mjuzikëll, vepra muzikore të ndryshme, duke zhvilluar aftësitë e tyre në njohjen më të plotë të muzikës.

Tekstet dhe materialet sigurojnë përmes përdorimit të tyre një qasje të përshtatshme me moshën dhe mundësinë e nivelit të të mësuarit. Me anë të medieve, detyrave dhe projekteve të ndryshme nxënësve/eve u krijohet mundësia të demonstrojnë apo tëprezantojnë punët dhe krijimet e tyre.

Muzika studiohet përmes njohjes dhe përdorimit të mjeteve, materialeve, teknikave e procedurave specifike muzikore p.sh.: për dëgjim muzikor, shikim të shfaqjeve përndjekjen e pjesëve muzikore, të këngëve përdoren magnetofoni, TV-ja, CD-ja dhe DVD-ja.

Përveç materialeve shfrytëzohen edhe burime mësimore si teksti shkollor, internet etj.

Disa nga mjetet më të përdorshme didaktike janë:

• *Mjetet audiovizive si:* Tv, magnetofon, video, video-projektor, kompjuter, internet, CD, DVD.

• *Mjetet dëgjimore:* radio, magnetofon etj.

• *Mjetet verbale, tekstet si:* tekstet mësimore (të detyruara), libri i mësues/it, fletoret e punës, katalogë, albume që mund të përdoren në shkollë për të mbështetur punën e nxënësve/eve dhe demonstruar vepra të ndryshme muzikore. Këto burime duhet të diskutohen dhe vlerësohen nga stafi si një pjesë e planit të tyre për muzikën. Ky plan është i rëndësishëm për të përzgjedhur burimet e dyta, të cilat ndihmojnë për të mbështetur nxënësit/et në punët e tyre krijuese dhe performuese, si dhe në krijime të ndryshme.

• *Mjedisi mësimor* (klasa, kabinetet e muzikës etj.).

V. ORGANIZIMI DHE KUPTIMI I TEKSTIT TË NXËNËSIT, SIPAS PROGRAMIT MËSISMOR

Ky tekst mësimor është organizuar në katër koncepte dhe tema mësimore. Ato janë:

1. Krijimtaria dhe performanca artistike

• Këngë
• Bllokflaut
• Krijim muzikor
• Krijim nëpërmjet solmizimit

2. Gjuha dhe komunikimi artistik

• Elementet muzikore
• Shkrimi dhe leximi muzikor
• Shkallët muzikore

3. Muzika dhe shoqëria
• Zhanret muzikore
• Gjinitë muzikore
• Instrumentet dhe formacionet muzikore
• Krijues dhe interpretues

4. Çmuarja dhe vlerësimi estetik-artistik
• Ngjarje muzikore
• Vepra muzikore

Në çdo njësi mësimore merren informacione të reja për këngët, veprat dhe kompozitorët nëpërmjet zhvillimit të veprimtarive muzikore: këndim, dëgjim, interpretim dhe vlerësim. Në fund, zotërohen njohuri dhe aftësi të mjaftueshme muzikore e kulturore, të cilat provohen në një testim, koncert apo paraqitje të një teme të caktuar, duke punuar vetëm ose në grup.

VI. KUPTIMI DHE INTERPRETIMI I SIMBOLEVE QË PËRNDJEKIN TEKSTIN E NXËNËSIT

Simboli në tekstin e nxënësit	Kuptimi i simbolit si e gjejmë në tekst
Dëgjo dhe diskuto	Dëgjim të vijës melodike të këngës/fragmente muzikore.
Luajmë me bllokflaut	Luajtje në instrument
Mëso	Mëso (njohuri muzikore)
A e dini se...	Informacione mbi ngjarje muzikore, kompozitorë shqiptarë, kosovarë dhe të huaj
Provo aftësitë e tua muzikore	Ushtrime ritmike dhe melodike, plotësime melortimike, Krijime muzikore
Çmo njohuritë muzikore	Luaj dhe krijo muzikë Çmo dhe vlerëso (këngën, krijimin, punimin, interpretimin) Çmim dhe vlerësim i muzikës
Çmo tekstin dhe melodinë e këngës	
Çmo interpretimin tënd dhe të shokut/shoqes	
Verifikojmë njohuritë	Vetëvlerësim dhe verifikim i njohurive muzikore të marra

PLANI VJETOR
FUSHA E KURRIKULËS: Arte
KLASA: E shtatë

Lëndët e fushës	Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve				Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës
krijuesLënda: Art muzikor	**PERIUDHA (I)**		**PERIUDHA (II)**	**PERIUDHA (III)**	Komunikues efektiv I.3, 7, 8, 9 Mendimi kreativ II.1, 3, 5, 7 Nxënës i suksesshëm III. 4, 5 Kontribuues produktiv IV. 1, 3 Individ i shëndoshë V.2 Qytetar i përgjegjshëm VI.1, 4
	Shtator-Tetor 9 orë	**Nëntor-Dhjetor 9 orë**	**Janar-Shkurt-Mars 8 orë**	**Prill-Maj Qershor 8 orë**	
	Këngë (3 orë)	Këngë (2 orë)	Këngë (2 orë)	Këngë/kanone (3 orë)	
	Interpretime në instrumente (1 orë)	Interpretime në instrumente (1 orë)	Interpretime në instrumente (1 orë)	Interpretime në instrumente (1 orë)	
	Krijim muzikor (1 orë)	Krijim muzikor (1 orë)	Krijim muzikor(1 orë)		
	Shkrimi leximi muzikor (3 orë)	Shkrimi leximi muzikor (1 orë)			
		Format muzikore (1 orë)	Format muzikore (2 orë)		
		Shkallët muzikore (1 orë)			
	Zhanret muzikore (1 orë)			Zhanret muzikore (1 orë)	
		Formacione instrumentale (1 orë)	Formacione artistike (1 orë)		
		Krijues dhe performues (1 orë)	Krijues dhe performues (1 orë)	Krijues dhe performues (1 orë)	
				Profesione muzikore (1 orë)	
				Ngjarje artistike (1 orë)	
	Planifikime (2 orë)				
	Çdo mësimdhënës planifikon temat që i duken të përshtatshme.				

PERIUDHA I
MUAJT: *SHTATOR – TETOR/NËNTOR – DHJETOR*
FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: ART MUZIKOR
KLASA: VII

TEMA MËSIMORE: KËNGË, INTERPRETIME ME INSTRUMENTE DHE KRIJIMET MUZIKORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit**.**
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal;
I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.
I.3. Interpreton individualisht ose në grup.
I.2. 3. Krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.
2.1. Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta.
2. 2. Zbulon dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të gjuhës artistike.
2.3. Eksperimenton dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike.
3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore

dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

3.2. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

3.3. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

1.1. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse.

TEMA MËSIMORE: ELEMENTET E GJUHËS ARTISTIKE, SHKRIMI MUZIKOR

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.

I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.

I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.

I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.

I.3. Interpreton individualisht ose në grup.

I.2. 3. krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.

2.1. Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta.

2. 2. Zbulon dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.

2.3. Eksperimenton dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike.

3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

3.2. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

3.3. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

1.2. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse.

TEMA MËSIMORE: ZHANRE MUZIKORE,GJINITË MUZIKORE, INSTRUMENTE DHE FORMACIONET MUIKORE, KRIJUES DHE PERFORMUES

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.

I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.

I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

PERIUDHA 1: SHTATOR-DHJETOR							
Temat mësim-ore	**Rezultatet e të nxënit**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësim-ore)**	**Metodolo-gjia e mësim-dhënies**	**Metodo-logjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë të tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurri-kulare**	**Bu-rimet**
Këngë **Interpretim në instrumente muzikore**	Nxënësit këndojnë këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respek-tuar teknikën e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup). Nxënësit sho-qërojnë këndi-min dhe luajnë pjesë të thjeshta instrumentale të zhanreve të ndryshme indi-vidualisht	Rikujtojmë njo-huritë nga klasa e gjashtë Këngë: himn Këngë: "Oda e gëzimit" Intervalet muz-ikore Klasifikimi i zërave Këngë: "Delja rude"	18	Bisedë Diskutim Brainstorming Diagrami i Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individ-uale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësimi i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sport dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë	Teksti shko-llor Softuere arsimore CD DVD

	dhe në grupe. Nxënësit improvizojnë me zë, me instrumente ritme dhe melodi në masa dhe forma të ndryshme muzikore.	Termat dinamikë Krijim muzikor me ritme të thjeshta				Çështjet ndërkurrikulare Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike
Krijim muzikor	Nxënësit shprehen me lëvizje/vallëzim, shprehje letrare e figurative, të frymëzuar nga muzika që dëgjojnë.	Nota dhe pushimi 1/8 me pikë vlerësuese				Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë
Elemente të gjuhës artistike	Nxënësit krijojnë melodi të reja për ritme e tekste të shkurtra poetike, të përzgjedhura, duke përdorur intonacionin muzikor dhe simbolet.	Kënga "Pëllumbi i bardhë"				Globalizimi dhe ndër-varësia Edukimi për media
Shkrimi/leximi muzikor	Përdorin me kreativitet elementet muzikore (ritmi, masat, melodia, harmonia, shkallët muzikore etj.) për të komunikuar me shprehje muzikore;	Muzika popullore, polifonike dhe homofonike				

Zhanret muzikore **Instrumente dhe formacione muzikore** **Llojet e muzikës** **Instrumentet muzikore** **Krijues**	përdorin elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë luajtjes në instrumente muzikore; marrin informacion; identifikojnë dhe dallojnë format kryesore me të cilat janë të ndërtuara veprat muzikore (fuga, sonata, oratoriumi, cantata, opera, simfonia etj.) përmes dëgjimit muzikor; reprodukojnë saktë lartësitë dhe gjatësitë e tingujve muzikore në bazë të rrokjeve të solmizimit dhe gjatësive ritmike (vlerat e notave) të këngëve që këndojnë; identifikojnë parimin e ndërtimit të shkallëve të ndryshme muzikore përmes këngëve, shembujve dëgjim dhe pasqyrave vizuale të shkallëve muzikore;	Shkalla D-Dur dhe H-Moll Luajmë në instrument Nota dhe pushimi 1/16 Format e thjeshta muzikore, Fuga – sonata Krijojmë së bashku Kënga “Gjuha jonë, barot e trëndelinë” Llojet e orkestrave Shkalla D-Dur dhe G-Moll				

	përdorin me sukses njohuritë për elementet muzikore në zbatimin e tyre praktik gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente. Nxënësit, përmes dëgjimit muzikor dallojnë dhe krahasojnë instrumentet përfaqësuese nga grupet e instrumenteve harkore, frymore dhe me goditje. Nxënësit dallojnë dhe krahasojnë ansamblet e ndryshme muzikore, sipas funksionit dhe llojit. Nxënësit njohin vepra artistike dhe krijuese, artistë të shquar nga krijimtari popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.	Kënga "Jam i lashtë se jam shqiptar" Krijues, interpretues, vepra Verifiko njohuritë Muzika jonë popullore				

PERIUDHA II
MUAJT: JANAR, SHKURT, MARS
FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: ART MUZIKOR
KLASA: VII

TEMA MËSIMORE: KËNGË, INTERPRETIME ME INSTRUMENTE DHE KRIJIMET MUZIKORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.
I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.
I.3. Interpreton individualisht ose në grup.
I.2. 3. Krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.
2.1. Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta.
2. 2. Zbulon dhe prezanton përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të gjuhës artistike.
2.3. Eksperimenton dhe përzgjedh mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike.
3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore

dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

3.2. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

3.3. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

1.3. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse.

TEMA MËSIMORE: ELEMENTET BAZIKE TË GJUHËS ARTISTIKE, SHKRIMI MUZIKOR

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.

I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.

I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.

I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.

I.3. Interpreton individualisht ose në grup.

I.2. 3. Krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.

2.1. Përdor elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta.

2. 2. Zbulon dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të gjuhës artistike.

2.3. Eksperimenton dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike.

3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

3.2. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

3.3.Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

1.4. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse.

TEMA MËSIMORE: ZHANRE MUZIKORE,GJINITË MUZIKORE, INSTRUMENTE DHE FORMACIONET MUIKORE, KRIJUES DHE PERFORMUES

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.

I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.

I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.

II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.

III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.

VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

PERIUDHA II: JANAR-MARS							
Temat mësimore	**Rezultatet e të nxënit për tema mësimore**	**Njësitë mësimore**	**Koha mësimore (orë mësimore)**	**Metodologjia e mësimdhënies**	**Metodologjia e vlerësimit**	**Ndërlidhja me lëndë e tjera mësimore dhe me çështjet ndërkurrikulare**	**Burimet**
Këngë **Interpretim në instrumente muzikore**	Nxënësit këndojnë këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar teknikën e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup). Nxënësit shoqërojnë këndimin dhe luajnë pjesë të thjeshta instrumentale të zhanreve të ndryshme individualisht dhe në grupe. Nxënësit improvizojnë me zë, me	Format muzikore: simfonia Luajmë në instrument Orkestrinat popullore Format muzikore kantatë, oratorio	8	Bisedë Diskutim Brainstorming Diagrami i Venit Harta e të pyeturit Kllaster Punë individuale	Buletini i pjesëmarrjes Portofoli i nxënësit Vlerësim i ndërsjellë	Njeriu dhe natyra Gjuhë shqipe Edukatë figurative Edukatë muzikore Edukata fizike, sporte dhe shëndeti Shoqëria dhe mjedisi Gjuhë angleze Matematikë **Çështjet ndërkurrikulare** - Mbrojtja e mjedisit	Teksti shkollor Softuerë arsimorë Cd Dvd

Krijim muzikor **Elementet të gjuhës artistike** **Shkrimi leximi muzikor**	instrumente ritme dhe melodi në masa të ndryshme e në forma të ndryshme muzikore. Nxënësit shprehen me lëvizje/vallëzim, shprehje letrare e figurative të inspiruar nga muzika e dëgjuar. Nxënësit krijojnë melodi të reja për ritme e tekste të shkurtra poetike të përzgjedhura duke përdorur edhe notacionin muzikor ose simbolet. Përdorin me kreativitet elementet muzikore (ritmi, masat, melodia, harmonia, shkallët muzikore etj.) për të komunikuar me shprehje muzikore; përdorin elementet muzikore në mënyrë efektive dhe kreative gjatë luajtjes në	Kënga: "A vritet pafajësia" Ushtrime me shkallët e mësuara Kënga: "We are the World" Përfaqësues dhe vepra muzikore "Të njohim kompozitorët tanë"				dhe zhvillimi i qëndrimeve ekologjike - Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm - Zhvillimi personal dhe shkathtësitë për jetë - Globalizimi dhe ndërvarësia - Edukimi për media	

Instrumente dhe formacione muzikore **Llojet e muzikë** **Instrumentet muzikore** **Krijues dhe performues**	instrumente muzikore; marrin informacion; identifikojnë dhe dallojnë format kryesore me të cilat janë të ndërtuara veprat muzikore (fuga, sonata, oratoriumi, cantata, opera, simfonia etj.) përmes dëgjimit muzikor. Reprodukojnë saktë lartësitë dhe gjatësitë e tingujve muzikore në bazë të rrokjeve të solmizimi dhe gjatësive ritmike (vlerat e notave) të këngëve që këndojnë; identifikojnë parimin e ndërtimit të shkallëve të ndryshme muzikore përmes këngëve, shembujve muzikorë për dëgjim dhe pasqyrave vizuale të shkallëve muzikore; përdorin me sukses njohuritë për elementet						

	muzikore në zbatimin e tyre praktik gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente. Nxënësit përmes dëgjimit muzikor dallojnë dhe krahasojnë instrumentet përfaqësuese nga grupet e instrumenteve harkore, frymore dhe me goditje. Nxënësit dallojnë dhe krahasojnë ansamblet e ndryshme muzikore, sipas funksionit dhe llojit. Nxënësit njohin vepra artistike dhe krijuese, artistë të shquar nga krijimtari popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.						

PERIUDHA III
MUAJT: PRILL, MAJ, QERSHOR
FUSHA E KURRIKULËS: ARTE
LËNDA MËSIMORE: ART MUZIKOR
KLASA: VII

TEMA MËSIMORE: KËNGË, INTERPRETIME ME INSTRUMENTE DHE KRIJIMET MUZIKORE

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.

Nxënës i suksesshëm:

III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kontribuues produktiv:

IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.

Individ i shëndoshë:

V.2 Dëshmim i vetëbesimit

Qytetar i përgjegjshëm:

VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultate e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.
I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.
I.3. Interpreton individualisht ose në grup.
I.2. 3. krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.
2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta.
2. 2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të gjuhës artistike.
2.3. Eksperimentojnë dhe përzgjedhin mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike, në realizimin e punimeve artistike.

3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

3.2. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

3.3.Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.

1.5. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse.

TEMA MËSIMORE: ELEMENTET TË GJUHËS ARTISTIKE, SHKRIMI MUZIKOR

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temave:

Komunikues efektiv:

I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.

I.7. Dhënia dhe pranimi i informatës kthyese në mënyrë konstruktive.

I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.

I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.

Mendimtar kreativ:

II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.

II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - kupton vlerën e notës dhe pushimit 1/8, duke demonstruar se i ka kuptuar drejt ato; - demonstron kuptimin e pikës së vlerës kur i bashkohet notës dhe pushimit 1/8 gjatë këndimit apo luajtjes në instrument; - shpjegon ndryshueshmërinë e ritmit gjatë këndimit apo luajtjes në instrument kur ekzekuton notën dhe pushimin 1/8 me pikë vlere; - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, magnetofon, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Gjuha amtare Përdorimi i shenjave dhe simboleve në një kontekst të dhënë letrar, gjeografik, historik, qytetar etj.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)

Mësimi fillon me një **veprimtari konkrete** ku mësimdhënësi paraqet ne dërrasë ose u kërkon nxënësve për 5 minuta të zbulojnë dhe japin përgjigje mbi ushtrimin e dhënë:



Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Vazhdohet më tej duke u shpjeguar nxënësve *notën tetëshe me pikë vlere si element i shkrimit dhe kuptimit të muzikës.*



Mësimdhënësi vazhdon me tej me konkretizimin e leximit të notës tetëshe me pikë vlere.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra duke përsëritur termat muzikore që mësuan nëpërmjet Diagramit të Venit.



Vlerësimi i nxënësve

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

- demonstrimin e kuptimit të vlerës së notës dhe pushimit 1/8, në ushtrime ritmike;
- demonstrimin e kuptimit të pikës së vlerës kur i bashkohet notës dhe pushimit 1/8 gjatë këndimit apo luajtjes në instrument;
- shpjegimin e ndryshueshmërisë së ritmit gjatë këndimit apo luajtjes në instrument kur ekzekuton notën dhe pushimin 1/8 me pikë vlere;
- përdorimin e një fjalori të thjeshtë muzikor.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të krijojnë një ushtrim në 8 masa muzikore me notë 1/8 me pikë vlere duke e kënduar dhe ekzekutuar ritmikisht dhe melodikisht.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (nota tetëshe me pikë vlere).

10

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** **Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Këndon këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar tekniken e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup).	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.
I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.
I.3. Interpreton individualisht ose në grup.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Këngë "Pëllumbi i bardhë"

Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Artet
Përdorimi i ngjyrave për të ngjyrosur ose skicuar një përjetim emocional nga muzika e këngës.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësimi fillon me një veprimtari **bisedë**, duke u kërkuar atyre të flasin për disa nga të drejtat e njeriut? Cili është simboli i paqes Nxënësit renditin disa nga të drejtat e njeriut duke diskutuar rreth tyre me njëri-tjetrin.
Ndërtimi i njohurive të reja
Vazhdohet puna me mësimin e këngës, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.
Dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd.
Procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
Demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
Këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit.
Mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
Mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
Interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
Përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.*
Përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*
Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.
Demonstrimi i rezultateve të arritura
Nxënësit:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth jetës në fshat dhe ndodhi apo përjetime që kanë patur;
- thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

I

Një dit' në dor' un' mora
pëllumbin e bardh' që lart
fluturon
e di sa fjal' i fola
që vetëm ai i dëgjon.
Dhe pastaj hapa duart
në qiell ti lart fluturon
fluturon në hapsir'
merr ti lart zemrën
dhe këngën time.

II

Dhe kur bërtet stuhia
edhe kur era s'pushon
jo nuk ka frik' pëllumbi i
paqes
fluturon.
Një dit' në dor' un' mora
pëllumbin e bardh'
që lart fluturon
e disa fjal' i fola,
fluturo.

Refreni

Sa shumë gëzohen fëmij't
kur shkojn' nëpër bot'
nëpër bot',
paqen përshëndesin.
Mbi krahë ëndrra plot drit'
kaq shumë dashuri
të përcjellin.

Vlerësimi
Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
- komunikimin qartë të njohurive muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;
- këndimin duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve/shoqeve;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.
Udhëzohen nxënësit për **vizatimin** e simbolit të të drejtave të fëmijëve.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

11

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** "Muzika popullore, homofonike dhe polifonike"		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Dallojnë dhe krahasojnë zhanret muzikore (muzikën artistike, popullore, zbavitëse, jaz, rok, muzikë festive etj.) përmes dëgjimit muzikor dhe këngëve që këndojnë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi I informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): VII.2. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Muzika popullore, homofonike dhe polifonike"			
Fjalët kyçe: homofoni, polifoni, popullore			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - identifikon muzikën popullore të kënduar në treva të ndryshme shqiptare dhe karakteristikat e saj; - identifikon dhe përshkruan karakteristikat e muzikës homofonike të kënduar sipas krahinave; - identifikon dhe përshkruan karakteristikat e muzikës polifonike të kënduar sipas krahinave; - shpjegon rëndësinë e iso-polifonisë; - përdor media (DVD, CD, magnetofon) për të prezantuar punën e vet; - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi muzikën popullore (isopilifonia, homofni, polifoni).			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta) Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situate ndërvepruese përmes **brainstorming (dëgjim i këngës "Janinës çi panë sytë"**, ku mësuesi/ja nxit nxënësit të flasin lidhur me këndimin polifonik dhe grupit që e këndon. Nxënësit diskutojnë në lidhje me të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.			

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)



Njohuritë e reja fillojnë me shpjegimin e rëndësisë së muzikës popullore, llojeve të të këndurit, karakteristikat, grupet e këngëtarëve të muzikës homofonike dhe polifonike
duke vendosur një hartë dhe përcaktuar ndarjen e muzikës popullore, sipas zonave që ata njohin:
- shpjegimin e karakteristikave të muzikës popullore (këndimit) sipas zonave;
- nxitjen e nxënësve për të bërë krahasimin e mënyrave të të këndurit homofonik dhe polifonik sipas krahinave;
- shpjegimin e rëndësisë së iso-polifonisë si një pasuri që ruhet edhe nga UNESKO.
- grumbullimin e shembujve muzikorë/këngëve popullore nga *youtube* apo *interneti,* duke diskutuar karakteristikat që ata kanë dhe duke veçuar pse ata i pëlqejnë këto karakteristika.
Më pas nxiten nxënësit të provojnë njohuritë që kanë dhe ato që morën në identifikimin e disa instrumenteve popullore.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)

Përsëritin njohuritë e marra mbi muzikën popullore, homofonike dhe polifonike.

Vlerësimi i nxënësve:

Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- identifikimin e muzikës popullore të kënduar dhe isoipolifonisë në treva të ndryshme shqiptare dhe karakteristikat e saj;
- shpjegimin e karakteristikave të muzikës homofonike dhe polifonike të kënduar sipas krahinave;
- krahasimin dhe gjykimin për këngën homofonike me atë polifonike;
- përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon) për të prezantuar punën e vet;
- ndarjen e njohurive me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë në zhanrin e muzikës popullore të kënduar homofonike dhe polifonike dhe shprehen emocionalisht rreth asaj që dëgjojnë.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

12

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor **Tema:** "Shkrim leximi muzikor" – Shkallët muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Identifikon parimin e ndërtimit të shkallëve të ndryshme muzikore përmes këngëve, shembujve muzikorë për dëgjim dhe pasqyrave vizuale të shkallëve muzikore. - Përdor me sukses njohuritë për elementet muzikore në zbatimin e tyre praktik gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Shkalla D –Dur dhe h- mol"			
Fjalët kyçe: shkallë maxhore, shkallë minore, Shkalla D –Dur dhe h - mol, akord, arpezh, T, ½ T			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - kupton ndërtimin e shkallës muzikore D-Dur dhe h- mol; - demonstron ndërton shkallën Re maxhore dhe si minore në ngjitje dhe në zbritje; - shpjegon funksionin e T nga 1/2 T në ndërtimin e shkallëve muzikore; - këndon akordin dhe arpezhin e shkallëve muzikore; - këndon gradët e shkallës në ngjitje dhe në zbritje.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Matematika			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta) Mësimi fillon me një **brainstorming** ku mësimdhënësi vendos disa numra dhe simbole mjaft të njohura për nxënësit/et që përdoren në matematikë I, II, III, IV etj., si dhe <> dhe i nxit që të diskutojnë dhe të nxjerrin kuptimin që kanë ato. Çfarë roli dhe funksioni mund të luajnë edhe në muzikë? Diskutimet ndihmojnë që ata/ato të kuptojnë vetë se sa të rëndësishme janë simbolet në jetën tonë të përditshme.			

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
*

Ora mësimore vazhdon më tej, kur mësimdhënësi fillon:
Shpjeguar **shkallën D-Dur** dhe **h-mol/ Akordin dhe arpezhin.**
Më pas ndërton shkallën Re + në dërrasë dhe shpjegon kuptimin e gradëve në muzikë dhe T dhe 1/2 tonit.
Gjatë ndërtimit të shkallës dhe vendosjes së gradëve dhe T e 1/2 T shkalla do të marrë formën e saj të plotë me të gjitha elementet e saj.









Akordi dhe arpezhi i shkallës Si minore ndërtohen mbi gradët 1-3-5-8.





Nxënësit lexojnë dhe këndojnë ushtrime në tonalitetin Re + dhe si - , duke plotësuar me të gjitha elementet përkatëse. **Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)** Përsëritin njohuritë e marra nëpërmjet **diskutimeve** mbi shkallët muzikore të mësuara. ***Vlerësimi i nxënësve:*** Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në: - ndërtimin e shkallës muzikore D-Dur dhe h- mol; - demonstrimin e ndërtimit të shkallës Do maxhore dhe la minore në ngjitje dhe në zbritje; - shpjegimin e funksionit të T nga 1/2 T në ndërtimin e shkallëve muzikore; - këndimin e akordit dhe arpezhit të shkallëve muzikore; - këndimin e gradëve të shkallës në ngjitje dhe në zbritje; - bashkëpunimin gjatë plotësimit të detyrës, vetëm ose në grup.
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të punojnë me ushtrimet e paraqitura në tekst me shkallët muzikore.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (shkallët muzikore D-Dur dhe h-mol).

13

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Interpretim në instrumente		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Luan individualisht dhe në grup, pjesë instrumentale, me dhe pa tekst notal si dhe shoqërojnë këndimin me instrumente muzikore që përdorin.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.
II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale. Ndërkulturore dhe shoqërore.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I.2.3. Krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Luajmë në instrument

Fjalët kyçe: rregullat e luajtjes në instrument, ritëm, melodi

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- luan pjesë të ndryshme me dy instrumente, duke respektuar simbolikat e mësuara në muzikë;
- luan në instrument, duke respektuar rregullat e ekzekutimit;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, instrumenti muzikor

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësimi fillon me një veprimtari **(bisedë)** me nxënësit, duke iu kërkuar atyre të rikujtojnë rregullat e luajtjes në instrument dhe bërë nxehjen me të.
Ndërtimi i njohurive të reja
Vazhdohet puna me mësimin luajtjes me dy instrumente muzikore të ushtrimeve apo pjesëve muzikore.
Demonstrohet nga mësimdhënësi pastaj nga nxënësit ushtrimi nga më i thjeshti tek më i vështiri.

Më pas vazhdohet ekzekutimi nga vetë nxënësit në grupe, duke u ushtruar.



Vlerësimi
Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
- demonstrimin me korrektësi të luajtjes së ushtrimeve muzikore për dy instrumente;
- ekzekutimin korrekt të notave muzikore sipas intervaleve në fyell/bllokflaut, duke respektuar rregullat e luajtjes;
- bashkëpunimin dhe respektimin e ritmit dhe intonacionit gjatë luajtjes së ushtrimeve me fyell/bllokflaut).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **përsëritjen e** ushtrimeve të tekstit në shtëpi.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

14

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor **Tema** "Shkrimi dhe leximi muzikor"		**Rezultati i të nxënit të temës:** Riprodhon saktë lartësitë dhe gjatësitë e tingujve muzikore në bazë të rrokjeve të solmizimi dhe gjatësive ritmike (vlerat e notave) të këngëve që këndojnë.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi I informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta 2. 2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Nota dhe pushimi 1/16"			
Fjalët kyçe: notë 1/16, pushimi 1/16			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore Nxënësi/ja: - demonstron kuptimin e vlerave/notës dhe pushimit 1/16; - lexon ushtrime ritmike me figurën muzikore të mësuar 1/16; - respekton ritmikisht gjatë leximit figurën 1/16 në ushtrime dhe pjesë të ndryshme; - komunikon qartë njohuritë muzikore, mbi njohuritë e reja dhe përdorimit të tyre në muzikë; - punon vetëm ose në grup.			

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Matematika
Përdorimi i thyesave dhe numrave në ritmin muzikor dhe kuptimi i vlerave muzikore përmes tyre.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situate ndërvepruese dhe gjithëpërfshirëse **(brainstorming)** ku vendoset një ushtrim për të kujtuar piramidën e notave. Nxitet diskutimi rreth tyre.



Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Veprimtaria vazhdon duke shpjeguar hap pas hapi kuptimin mbi përdorimin e notës dhe pushimit 1/16. Shpjegohet përmes një tabele koncepti i notës dhe pushimit 1/16.

Notat	Pushimet	Paraqitja grafike	Vlerat
e plotë			*e plotë* 4/4
gjysmë			*gjysmë* 2/4
çerekëshe			*çerekëshe* 1/4
tetëshe			*tetëshe* 1/8
16-she			*16-she* 1/16

Vazhdohet më tej me leximin e figurës ritmike:



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra duke lexuar rrjedhshëm ushtrimet e tekstit.

Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- demonstrimin në ushtrime të ndryshme të vlerave/notës dhe pushimit 1/16;
- leximin saktë të ushtrimeve ritmike me *figurën muzikore të mësuar 1/16*;
- respektimin ritmikisht gjatë leximit të figurës 1/16 në ushtrime dhe pjesë të ndryshme;
- komunikimin qartë të njohurive të reja dhe përdorimit të tyre në muzikë.

Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të identifikojnë dhe lexojnë figurën muzikore 1/16 në ushtrime të ndryshme muzikore.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re mbi notën dhe pushimin 1/16.

15

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** **Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës:** **III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: "Muzika dhe shoqëria" **Tema:** "Zhanret muzikore"		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Merr informacione për strukturën formale të veprave muzikore. - Ientifikon dhe dallojnë format kryesore me të cilat janë të ndërtuara veprat muzikore (fuga, sonata, oratoriumi, cantata, opera, simfonia etj.) përmes dëgjimit muzikor.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta 2. 2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementëve të gjuhës artistike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Format muzikore, fuga dhe sonata"			
Fjalët kyçe: formë muzikore, fugë, sonatë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - lidh njohuritë që ka mbi format muzikore me njohuritë e reja; - shpjegon karakteristikat e formës së fugës dhe sonatës; - krahason dy vepra muzikore të së njëjtës formë dhe të formave të ndryshme (figa dhe sonata) duke dhënë të veçantat dhe të përgjithshmet; - komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara duke përcaktuar formën e tyre muzikore; - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.			

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Arti pamor
Përdorimi i koncepteve të artit pamor për të krijuar forma të ndryshme artistike.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një **brainstorming** përmes një skeme të gatshme e cila i nxit nxënësit të rikujtojnë njohuritë e marra vitin e shkuar për format muzikore.

Skema e tri formave muzikore



Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Vendoset për dëgjim një fugë e Bahut dhe jepen disa karakteristika të saj.



Shpjegohet mënyra e ndërtimit të formës së fugës dhe sonatës.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi formën e fugës dhe sonatës.

Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- shpjegimin e karakteristikave të formës së fugës dhe sonatës;
- krahasimin e dy vepra muzikore të së njëjtës formë dhe të formave të ndryshme (figa dhe sonata) duke dhënë të veçantat dhe të përgjithshmet;
- komunikimin e mendimit e vet rreth veprave muzikore të dëgjuara duke përcaktuar formën e tyre muzikore;
- përdorimin e një fjalor të thjeshtë muzikor.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të përdorin njohuritë që morën në jetën e tyre të përditshme.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

16

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Krijim muzikor		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Shprehen me lëvizje/vallëzim, shprehje letrare e figurative të inspiruar nga muzika e dëgjuar. krijojnë melodi të reja për ritme e tekste të shkurtra poetike të përzgjedhura duke përdorë edhe notacionin muzikor ose simbolet.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9. Inicimi I veprimeve konstruktive. II.5. Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.1. Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënit. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Krijojmë së bashku			
Fjalët kyçe: krijim, ngjyrat e ngrohta, ngjyrat e ftohta, ngjyrat plotësuese			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - krijon punë të ndryshme bazuar në njohuritë muzikore, mbi ritmet e mësuara dhe simbolet muzikore; - krijon në ritme të ndryshme, duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh; - shpjegon ndryshueshmërinë e muzikës gjatë përdorimit të vlerave të ndryshme të notave dhe pushimeve; - krijon punimin e vet duke u frymëzuar nga artet e tjera; - respekton punën e vet dhe të shokut.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një rikujtim të gjitha njohurive muzikore që nxënësit u duhen për punimin e tyre. Ata rikujtojnë edhe njohuri të lëndëve të tjera për ti përdorur më pas gjatë punës së tyre. Për shembull një orientim është Arti pamor dhe koncepti i ngjyrave.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

ⓐ ***Ngjyrat e ngrohta*** janë***: e kuqe, blu, e verdhë*** të cilat shprehin agresivitet ose alegri, gëzim, gjallëri.
Duke dëgjuar këngën *"Ju fal këngën time"* fillo të krijosh një punim duke përdorur pikërisht ngjyrat e ngrohta.
Tempi i këngës*: Allegro*
Karakteri i këngës*: i gëzueshëm, i gjallë*
Tipet e ngjyrave*: të ngrohta*

ⓑ ***Ngjyrat e ftohta*** janë***: jeshile, vjollcë, portokalli*** të cilat shprehin melankoli apo qetësi.
Duke dëgjuar minuetin e kompozitorit J.S.Bah fillo të krijosh një punim duke përdorur pikërisht ngjyrat e ftohta.
Tempi i minuetit*: Andante*
Karakteri i minuetit*: i qetë*
Tipet e ngjyrave*: të ftohta*

ⓒ ***Ngjyrat e plotësuese ose komplementare*** janë sipas ***tonaliteteve*** që ato krijojnë nga bashkimi i ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta.

Duke dëgjuar sonatën "Per Eliza" e kompozitorit L.V.Bethoven fillo të krijosh një punim duke përdorur pikërisht ngjyrat plotësuese.
Tempi i sonatës*: Allegreto*
Karakteri i sonatës*: i ndryshueshëm*
Tipet e ngjyrave*: të zbehta, të shuara*

Një grup mund të krijojë mbi ritmet e mësuara. Ata duhet të plotësojnë krijimin e tyre, duke rikujtuar të gjitha njohurit e marra mbi ritmet muzikore dhe të gjitha simbolet e mësuara.
Demonstrimi i rezultateve të arritura
Diskutojnë me njëri-tjetrin rreth krijimeve që ata kanë bërë në punimet e tyre.

Vlerësimi
Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
- krijimin e punëve të ndryshme bazuar në njohuritë figurative dhe muzikore, mbi ritmet e mësuara dhe konceptet e ngjyrës;
- krijimin në ritmet muzikore duke përdorur kombinime të ndryshme vlerash notash dhe pushimesh;
- prezantimin e krijimit të vet duke shpjeguar me një fjalor të thjesht atë;
- shpjegimin e ndryshueshmërisë së muzikës gjatë përdorimit të vlerave të ndryshme të notave dhe pushimeve;
- respektimin e punës e vet dhe të shokut.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **çmuarjen e krijimit** dhe respektimin e punimit të shokëve.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

17

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - këndon këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar tekniken e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal. I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë. I.3. Interpreton individualisht ose në grup.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Gjuha jonë barot e trendelinë			
Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet Përdorimi i ngjyrave për të ngjyrosur ose skicuar një përjetim emocional nga muzika e këngës.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësimi fillon me një veprimtari **bisedë**, duke u kërkuar atyre të flasin për personin më të shtrenjtë që është *nëna.* Nxënësit listojnë disa karakteristika që veçojnë te mamatë e tyre duke diskutuar rreth tyre me njëri-tjetrin.

Ndërtimi i njohurive të reja
Vazhdohet puna me mësimin e këngës, duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

- Dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd.
- Procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- Demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- Këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit.
- Mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- Mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- Interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- Përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.*
- Përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Demonstrimi i rezultateve të arritura
Nxënësit:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth familjes;
- thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

- I -
Gjuha jonë sa e mir',
sa e ëmbël, sa e dlir',
mbetën thell' o tek ajo
një bilbil dhe një
shqiponj'.
Zëri ëmbël dhe i fort'
si kushtrim, o nëpër bot'.

- Refreni -
Tha një popull historinë
dhe gjuhës i këndoi,
gjuh' e arbrit, gjuha jonë
barot e trëndelin'.
Ti mban sot o në çdo
shkronjë dëshirën për liri,
gjuh' e arbrit, gjuha jonë
barot e trëndelin'.

- II -
Gjuha jonë sa e mir',
sa e ëmbël, sa e dlir',
thell' në zemër të çdo trimi
mbeti gjuha si kushtrim.
Brez pas brezi ti kalon,
si lirinë ty të
mbrojm'.

Vlerësimi
Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve:
- komunikimin qartë të njohurive muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;
- këndimin duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve/shoqeve;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj. Udhëzohen nxënësit për **shkrimin e një mesazhi** drejtuar nënës.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

18

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** "Instrumentet dhe formacionet muzikore"		**Rezultati i të nxënit të temës:** – Dallon nëpërmjet dëgjimit instrumentet dhe krahasojnë instrumentet përfaqësuese nga grupet e instrumenteve harkore, frymore dhe me goditje.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
1.3. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj.
4.1. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e forma të tjera shprehëse.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: "Llojet e orkestrave"

Fjalët kyçe: orkestër simfonike, orkestra filarmonike e Kosovës.

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja
- dëgjon në CD dhe identifikon ndonjë lloj - formacioni instrumental muzikor;
- klasifikon formacionet muzikore sipas - njohurive që merr;
- shfaq parapëlqimin e vet për një formacion - muzikor, duke sjellë shembuj të ndryshëm dëgjimorë me CD;
- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve gjatë diskutimeve të dëgjimit të pjesëve
- muzikore;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete **Brainstorming** ku vendosen për dëgjim CD me fragmente të shkurtra muzikore, duke i nxitur përsëri nxënësit të gjejnë se çfarë informacioni kanë për formacionet muzikore që dëgjojnë. Të gjithë nxënësit shprehin njohuritë e tyre dhe respektojnë mendimin e njëri-tjetrit. zhvillohet një kuic i shkurtër, përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave.

ⓐ kuartet; ⓑ kompleks harqesh; ⓒ bandë simfonike; ⓓ orkestër simfonike.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, teksa mësimdhënësi vendos shembuj muzikorë të luajtur nga formacione të ndryshme muzikor. Nxitet vëmendja për një dëgjim të kujdesshëm që të kuptohet ndryshimi jo vetëm nëpërmjet përbërjes së numrit që ka një formacion muzikor, por edhe nëpërmjet identifikimit nëpërmjet dëgjimit.
Nxënësit/et pasi kanë dëgjuar disa pjesë të ekzkeutuara nga këto formacione përzgjedhin formacionin muzikor që do të dëshironin të dëgjonin më shpesh në *youtube, CD etj.*
Mësimdhënësi shpjegon evoluimin e formacioneve muzikore nga krijimi deri në ditët tona.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës së **bisedës** ku nxiten nxënësit të flasin rreth orkestrës simfonike të Shqipërisë dhe asaj Filarmonike të Kosovës.

Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- dëgjimin e fragmenteve muzikore instrumentale, duke bërë klasifikimin e instrumenteve muzikore;
- dallimin e pjesëve të ndryshme muzikore instrumentale, ku shpjegon pse i pëlqen një instrument i caktuar;
- gjetjen dhe prurjen në klasë me CD/DVD të pjesëve instrumentale, sipas klasifikimit të instrumenteve të parapëlqyera;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë **pjesë për orkestër simfonike**, grumbullojnë informacion dhe prezantojnë punën e vet.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

19

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor **Tema:** "Shkrim leximi muzikor" – Shkallët muzikore		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Identifikon parimin e ndërtimit të shkallëve të ndryshme muzikore përmes këngëve, shembujve muzikorë për dëgjim dhe pasqyrave vizuale të shkallëve muzikore. - Përdor me sukses njohuritë për elementet muzikore në zbatimin e tyre praktik gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të gjuhës artistike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Shkalla H –Dur dhe g- moll"			
Fjalët kyçe: shkallë maxhore, shkallë minore, Shkalla H –Dur dhe g - mol, akord, arpezh, T, ½ T			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - kupton ndërtimin e shkallës muzikore H-Dur dhe g- mol; - demonstron ndërton shkallën Re maxhore dhe si minore në ngjitje dhe në zbritje; - shpjegon funksionin e T nga 1/2 T në ndërtimin e shkallëve muzikore; - këndon akordin dhe arpezhin e shkallëve muzikore; - këndon gradët e shkallës në ngjitje dhe në zbritje.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:			
Matematika			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta) Mësimi fillon me një **brainstorming** ku mësimdhënësi ku vendos disa numra dhe simbole mjaft të njohura për nxënësit/et që përdoren në matematikë I, II, III, IV etj., si dhe <> dhe i nxit që të diskutojnë dhe të nxjerrin kuptimin që kanë ato. Çfarë roli dhe funksioni mund të luajnë edhe në muzikë? Diskutimet ndihmojnë që ata/ato të kuptojnë vetë se sa të rëndësishme janë simbolet në jetën tonë të përditshme.			

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Ora mësimore vazhdon më tej, kur mësimdhënësi fillon:
Shpjeguar **shkallën H-Dur** dhe **g-mol/ Akordin dhe arpezhin.**
Më pas ndërton shkallën Re + në dërrasë dhe shpjegon kuptimin e gradëve në muzikë dhe Tdhe 1/2 tonit.
Gjatë ndërtimit të shkallës dhe vendosjes së gradëve dhe T e 1/2 T shkalla do të marrë formën e saj të plotë me të gjitha elementet e saj.







Akordi dhe arpezhi i shkallës Sol minore ndërtohen mbi gradët 1-3-5-8.



Nxënësit lexojnë dhe këndojnë ushtrime në tonalitetin Si*b* + dhe sol - , duke plotësuar me të gjitha elementet përkatëse.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra nëpërmjet **diskutimeve** mbi shkallët muzikore të mësuara.

Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- ndërtimin e shkallës muzikore H-Dur dhe g- moll;
- demonstrimin ndërton shkallën Do maxhore dhe la minore në ngjitje dhe në zbritje;
- shpjegimin funksionin e T nga 1/2 T në ndërtimin e shkallëve muzikore;
- këndimin e akordi dhe arpezhit të shkallëve muzikore;
- këndimin e gradëve të shkallës në ngjitje dhe në zbritje.
- bashkëpunimin gjatë plotësimit të detyrës, vetëm ose në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të punojnë me ushtrimet e paraqitura në tekst me shkallët muzikore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (shkallët muzikore H-Dur dhe g-moll).

20

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: *III***	**Klasa: *VII (shtatë)***
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Këndon këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar tekniken e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal. I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë. I.3. Interpreton individualisht ose në grup.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Këngë "Jam i lashtë se jam shqiptar"			
Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore: - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet Përdorimi i ngjyrave për të ngjyrosur ose skicuar një përjetim emocional nga muzika e këngës.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			
Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve Mësimi fillon me një veprimtari **bisedë**, duke u kërkuar atyre të flasin për ndjenjën që ata kanë duke qenë shqiptarë. Nxënësit flasin për vendin e tyre duke diskutuar rreth me njëri-tjetrin.			

Ndërtimi i njohurive të reja

Vazhdohet puna me mësimin e këngës "Jam i lashtë se jam shqiptar", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

- Dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd.
- Procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- Demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- Këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit.
- Mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- Mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- Interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- Përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha st rofave.*
- Përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Demonstrimi i rezultateve të arritura

Nxënësit:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth Shqipërisë, Kosovës;
- thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

- I -
Çdo fëmij'në k'të bot'
ka një fis, miq e shok',
ka një vend ku ka ler',
ka një nën' e një atdhe.
- II -
Çdo fëmij' mbi k'të tok'
ka një gjuh', ka një fe,
ka një vend ku ka ler',
ka një nën' e një atdhe.
- Refreni -
Ndaj buron nga zemra
dhe me qiellin kënga,
jam i par' ndaj jam krenar
se un' jam shqiptar.
Ndaj buron nga zemra
dhe me qiellin kënga,
jam i lasht' ndaj jam krenar
se un' jam shqiptar.
Un' jam krenar
se jam shqiptar,
ndaj jam krenar
se jam shqiptar.

Vlerësimi

Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
- komunikimin qartë të njohurive muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;
- këndimin duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve/shoqeve;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.
Udhëzohen nxënësit për **shkrimin e një eseje** kushtuat atdheut.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

21

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** "Krijues dhe performues"		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Njohin vepra artistike dhe krijuese, artistë të shquar nga krijimtari popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Krijues, interpretues, vepra

Fjalët kyçe: interpretim, performim, përkryerje artistike

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- identifikon përfaqësues dhe interpretues të muzikës shqiptare përmes dëgjimit;
- shpjegon veprat instrumentale dhe vokale të kompozitorëve shqiptarë dhe kosovarë;
- shfaq parapëlqimin e vet për muzikën e kompozitorit të parapëlqyer, duke argumentuar veprën muzikore;
- sjell informacione për krijuesit dhe përfaqësuesit më të njohur të muzikës shqiptare dhe kosovare;
- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet
Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko dhe kulturore.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete (**brainstorming**), përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, nga kompozitorë shqiptarë dhe kosovarë/gjatë 20-30 sekondave. Vendosen CD me fragmente muzikore shqiptare. Ata/ato flasin rreth njohurive që kanë për këto lloj instrumentesh.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, me një **teknikë Harta e të pyeturit** ku mësimdhënësi paraqet foto nga kompozitorë ose emrat e tyre dhe u kërkon nxënësve/eve t'i identifikojnë ato sipas njohurive që kanë për ta.



Vazhdohet me dëgjimin e fragmenteve muzikore dhe nxënësit arrijnë të krahasojnë stilin dhe përmbajtjen emocionale të veprës muzikore të kompozitorëve shqiptarë dhe kosovarë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës **Diagrami i Venit** ku vendosen dy kompozitorë shqiptarë dhe kosovarë, çfarë i dallon dhe ajo që i bashkon ata.
Përgjigjet mund të jenë të ndryshme:

- Stili muzikor
- Biografia
- Format muzikore që ka kompozuar

Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

- dëgjimin e fragmenteve muzikore instrumentale, duke bërë listuar përfaqësuesit shqiptarë dhe kosovarë krijues që kanë dhënë kontributin e tyre;
- shpjegimin e veprave që dëgjon duke thënë pse i pëlqen muzika apo interpretimi muzikor;
- grumbullimin dhe prurjen në klasë me CD/DVD të pjesëve muzikore shqiptare dhe kosovare;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë **interpretime nga repertori i krijuesve të ndryshëm shqiptarë dhe kosovarë** përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

22

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: "Muzika dhe shoqëria" **Tema** " Zhanret muzikore"		**Rezultati i të nxënit të temës** - Merr informacione për strukturën formale të veprave muzikore. - Identifikon dhe dallojnë format kryesore me të cilat janë të ndërtuara veprat muzikore (fuga, sonata, oratoriumi, cantata, opera, simfonia etj.) përmes dëgjimit muzikor.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.1. Përdorin elementet e gjuhës së artit për të komunikuar idetë e veta. 2. 2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të gjuhës artistike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Format muzikore, simfonia"			
Fjalët kyçe: formë muzikore, simfoni, kohët e simfonisë			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - lidh njohuritë që ka mbi format muzikore me njohuritë e reja; - shpjegon karakteristikat e formës së simfonisë; - krahason dy vepra muzikore të së njëjtës formë (simfonia 1 Ç. Zadeja dhe simfonia 2 R. Mulliqi) duke dhënë dy karakteristika; - komunikon mendimin e vet rreth veprave muzikore që dëgjon (instrumentale), duke përcaktuar formën e tyre muzikore; - përdor një fjalor të thjeshtë muzikor.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Arti pamor Përdorimi i koncepteve të artit pamor për të krijuar forma të ndryshme artistike.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një **brainstorming** përmes një skeme të gatshme e cila i nxit nxënësit të rikujtojnë njohuritë e marra për format muzikore.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Vendoset për dëgjim fragment nga tema e simfonisë nr. 1 e kompozitorit Çesk Zadesë dhe simfonisë 2 e Rexho Mulliqit dhe nxënësit japin dy karakteristika nga dëgjimi.



Shpjegohet zhvillimi i muzikës instrumentale në Shqipëri dhe Kosovë duke u ndalur në kompozitorë dhe veprat që krijuan ata.
Dëgjohen fragmente muzikore nga vepra të ndryshme instrumentale duke përcaktuar koloritin e motiveve muzikore që ata dëgjojnë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Nëpërmjet teknikës së Diagramit të Venit nxënësit rikujtojnë njohuritë për muzikën instrumentale.



Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- shpjegimin e karakteristikave të muzikës instrumentale në Shqipëri dhe Kosovë;
- krahasimin e dy vepra muzikore të së njëjtës formë (simfonia) nga autorë shqiptarë, duke dhënë të veçantat dhe të përgjithshmet;
- komunikimin e mendimit të vet rreth veprave muzikore që dëgjon (instrumentale), duke përcaktuar formën e tyre muzikore;
- përdorimin e një fjalor të thjeshtë muzikor.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të përdorin njohuritë që morën në jetën e tyre të përditshme.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

23

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** **Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës:** **III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Interpretim në instrumente		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Luan individualisht dhe në grup, pjesë instrumentale, me dhe pa tekst notal si dhe shoqërojnë këndimin me instrumente muzikore që përdorin.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.
II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale. Ndërkulturore dhe shoqërore.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I.2.3. Krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Luajmë në instrument

Fjalët kyçe: rregullat e luajtjes në instrument, ritëm, melodi

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- luan pjesë të ndryshme me dy instrumente, duke respektuar simbolikat e mësuara në muzikë;
- luan në instrument, duke respektuar rregullat e ekzekutimit;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, instrumenti muzikor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësimi fillon me një veprimtari (bisedë) me nxënësit, duke iu kërkuar atyre të rikujtojnë rregullat e luajtjes në instrument dhe bërë nxehjen me të.
Ndërtimi i njohurive të reja
Vazhdohet puna me mësimin luajtjes me dy instrumente muzikore të ushtrimeve apo pjesëve muzikore që ka në tekst.
Demonstrohet nga mësimdhënësi pastaj nga nxënësit ushtrimi nga më i thjeshti te më i vështiri.



Më pas vazhdohet ekzekutimi nga vetë nxënësit në grupe, duke u ushtruar.

Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve: - demonstrimin me korrektësi të luajtjes së ushtrimeve muzikore në instrumentin muzikor. - ekzekutimin korrekt të notave muzikore sipas intervaleve në fyell/bllokflaut, duke respektuar rregullat e luajtjes. - bashkëpunimin dhe respektimin e ritmit dhe intonacionit gjatë luajtjes së ushtrimeve me fyell/ bllokflaut).
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit për **përsëritjen e** ushtrimeve të tekstit në shtëpi.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

24

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** **Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës:** **III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** "Instrumentet dhe formacionet muzikore"		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Dallon dhe krahason ansamblet e ndryshme muzikore, sipas funksionit dhe llojit. - Njeh vepra artistike dhe krijuese, artistë të shquar nga krijimtari popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.4. Identifikon dhe dallon zhvillimet stilistike në format e ndryshme të veprave artistike (p.sh., portreti në stile të ndryshme, opera në stile e periudha të ndryshme etj. 4.2. Komenton dhe shprehet për veprat e përjetuara artistike me bisedë, ese, poster, prezantim e formatë tjera shprehëse.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Orkestrinat popullore"			
Fjalët kyçe: orkestër popullore heterotimbrike - homotimbrike			

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- dëgjon në CD dhe identifikon llojin e formacionit instrumental muzikor **popullor**;
- klasifikon *orkestrinën popullore heterotimbrike - homotimbrike* sipas - njohurive që merr;
- shfaq parapëlqimin e vet për një formacion - muzikor, duke sjellë shembuj të ndryshëm dëgjimorë me CD;
- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/ shoqeve gjatë diskutimeve të dëgjimit të pjesëve muzikore;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete **Brainstorming** ku vendosen për dëgjim CD me fragmente të shkurtra muzikore, duke i nxitur përsëri nxënësit të gjejnë se çfarë informacioni kanë për formacionet muzikore popullore që ata dëgjojnë. Të gjithë nxënësit shprehin njohuritë e tyre dhe respektojnë mendimin e njëri-tjetrit. Zhvillohet një kuic i shkurtër, përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave.

Orkestër heterotimbrike

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, teksa mësimdhënësi vendos shembuj muzikorë të luajtur nga formacione të ndryshme muzikore popullore. Nxitet vëmendja për një dëgjim të kujdesshëm që të kuptohet ndryshimi jo vetëm nëpërmjet përbërjes së numrit të instrumenteve dhe llojeve të tyre në grupin e familjes së instrumenteve ku bëjnë pjesë, duke i identifikuar ato nëpërmjet dëgjimit.

Nxënësit/et pasi kanë dëgjuar disa pjesë të ekzekutuara nga këto orkestrina popullore përzgjedhin formacionin muzikor që do të dëshironin të dëgjonin më shpesh në *youtube, CD etj.*
Mësimdhënësi shpjegon një historik të shkurtër rreth orkestrina muzikore popullore shqiptare dhe instrumentet që e përbëjnë ato.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës së **bisedës** ku nxiten nxënësit të flasin rreth orkestrinës popullore he=terotimbrike dhe homotimbrike në Shqipëri dhe Kosovë.

Vlerësimi i nxënësve: Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në: - identifikimin nëpërmjet dëgjimit në CD llojin e formacionit instrumental muzikor **popullor**; - klasifikimin e *orkestrinës popullore heterotimbrike nga ajo homotimbrike*; - shfaqin duke shpjeguar parapëlqimin e vet për një formacion - muzikor, duke sjellë shembuj të ndryshëm dëgjimorë me CD; - respektimin dhe vlerësimin e mendimit të shokëve/ shoqeve gjatë diskutimeve të dëgjimit të pjesëve muzikore. - bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë **pjesë të luajtura nga orkestrina të ndryshme popullore shqiptare**, grumbullojnë informacion dhe prezantojnë punën e vet.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

25

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** **Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës:** **III**	**Klasa: VII** **(shtatë)**
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** "Gjinitë, llojet muzikore"		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Përmes dëgjimit muzikor dallojnë dhe krahasojnë muzikën vokale, instrumentale, vokalo-instrumentale dhe muzikën skenike përmes shembujve muzikorë nga krijimtaria muzikore botërore dhe kombëtare.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Format muzikore vokale, kantata dhe oratorio"			
Fjalët kyçe: formë vokale, cantata, oratorio			

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- identifikon kuptimin e muzikës vokale përmes formave muzikore nga më e vogla deri tek ato më të mëdhatë;
- identifikon përmes dëgjimit *kantatën dhe oratorion* përmes veprave të kompozitorëve shqiptarë dhe botërore;
- shpjegon emocionet e përjetuara për një nga format muzikore;
- kërkon dhe prezanton dy vepra muzikore vokale: kantatë dhe oratori, përmes mediave të ndryshme (DVD, CD, magnetofon);
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia
Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi muzikën vokale.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situate ndërvepruese përmes **dëgjimit**, të dy veprave muzikore:
Cantata "Fjala e Skënderbeut" E.Rizvanolli dhe "Kantata mbi fshatin" e Bahut dhe ku mësuesi/ja nxit nxënësit të flasin në lidhje me to. Nxënësit diskutojnë duke dëgjuar mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Njohuritë e reja fillojnë me shpjegimin e kuptimi të formave vokale *cantata dhe oratorio.*



Vazhdohet më tej duke dëgjuar fragmente nga vepra të kompozitorëve të ndryshëm shqiptarë, kosovarë dhe të huaj, duke i nxitur nxënësit të gjejnë disa karakteristika nga këto dy gjini.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi dy format muzikore vokale përmes teknikës së Diagramit të Venit.



Vlerësimi i nxënësve: Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në: - shpjegimin e kuptimit të muzikës vokale përmes formave muzikore nga më e vogla deri tek ato më të mëdhatë; - identifikimin përmes dëgjimit *kantatën dhe oratorion* përmes veprave të kompozitorëve shqiptarë dhe botërore; - ndarjen e emocioneve të përjetuara për një nga format muzikore; - kërkimin dhe prezantimin e dy veprave muzikore vokale: kantatë dhe oratori, përmes mediave të ndryshme (DVD, CD, magnetofon); - bashkëpunimin duke ndarë njohuritë e veta me të tjerët.
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë në veprën e tyre të parapëlqyer dhe krijojnë një punim të vetin.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

26

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** **Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës:** **III**	**Klasa: VII** **(shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Këndon këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar tekniken e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal. I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë. I.3. Interpreton individualisht ose në grup.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Këngë "A vritet pafajësia"			
Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim			

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Artet
Përdorimi i ngjyrave për të ngjyrosur ose skicuar një përjetim emocional nga muzika e këngës.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësimi fillon me një veprimtari **bisedë**, duke u kërkuar atyre të flasin për ndjenjën që ata kanë duke qenë shqiptarë, luftën e Kosovës.
Nxënësit flasin për vendin e tyre duke diskutuar rreth me njëri-tjetrin.

Ndërtimi i njohurive të reja
Vazhdohet puna me mësimin e këngës "A vritet pafajësia", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.
- Dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd.
- Procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- Demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- Këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit.
- Mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- Mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- Interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- Përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave*
- Përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

-I

A vritet pafajsia,
çfarë faji ka Drenica,
se tremben nga fëmija,
që thrret' Azem Galica.
Drenica lind veç trima,
ju i lini fëmijt' jetima,
është një komb që don' liri'
dhe Kosova është Shqipri.

-II
Dhe
loti vjen tek gjaku
dhe gjaku vjen tek loti,
ja foshnjat po i vrasin,
po kullat jo nuk lozin.
Drenica lind veç trima,
ju i lini fmijt' jetima,
është një komb që don' lirin',
dhe Kosova është Shqipri.

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Demonstrimi i rezultateve të arritura
Nxënësit:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth Shqipërisë, Kosovës;
- thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve: - komunikimin qartë të njohurive muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndimin duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion; - respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve/shoqeve; - bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj. Udhëzohen nxënësit për **shkrimin e një eseje** kushtuat atdheut.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

27

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII(shtatë)**
Konceptet: Gjuha dhe komunikimi artistik muzikor **Tema:** "Shkallët muzikore"		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Identifikon parimin e ndërtimit të shkallëve të ndryshme muzikore përmes këngëve, shembujve muzikorë për dëgjim dhe pasqyrave vizuale të shkallëve muzikore. - Përdor me sukses njohuritë për elementet muzikore në zbatimin e tyre praktik gjatë këndimit dhe luajtjes në instrumente.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive. II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore. II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4 Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 2.2. Zbulojnë dhe prezantojnë përmbajtjen e veprave të artit nëpërmjet analizës së elementeve të gjuhës artistike.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Ushtrime në shkallët e mësuara"			
Fjalët kyçe: shkallë maxhore, shkallë minore, shenjat e shartimit tonalitet maxhor/minor			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - lexon ritmikisht ushtrimet në shkallët e mësuara; - këndon në intonacion ushtrimet melodike në shkallët e mësuara maxhore dhe minore; - argumenton përdorimin e shenjave të shartimit dhe funksionin e tyre në melodi dhe ushtrime; - ekzekuton ushtrimet melodike në instrument.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore.			
Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:			

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Mësimi fillon duke bërë një **brainstorming** lidhur me elementet muzikore vlerat e notave dhe pushimeve si dhe tonalitetet të ushtrimeve.
Diskutimet ndihmojnë që ata të rikujtojnë elementet muzikore.



Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Ora mësimore vazhdon më tej, kur mësimdhënësi drejton nxënësit në mësimin e ushtrimeve melodike në tonalitete muzikore të mësuara maxhore dhe minore.
Nxënësit fillojnë të këndojnë akordin dhe arpezhin e shkallëve të mësuara dhe më pas të këndojnë ushtrimet melodike nga fillimi në fund duke respektuar *intonacionin, ritmin, dhe elementet e tjera muzikore në to.*

Ushtrimet fillohen nga më i thjeshti deri te më e vështira. Këndohen me nota ose me fjalë, sipas ushtrimit të dhënë në tekst.



Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin ushtrimet duke u ndarë në grupe dhe kënduar ato për të demonstruar sa më mirë njohuritë muzikore.

Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- leximi ritmikisht ushtrimet në tonalitetet e mësuara;
- këndimin e ushtrimeve melodike në intonacion sipas tonaliteteve në shkallët e mësuara maxhore dhe minore;
- argumentimin në përdorimin e shenjave të shartimit dhe funksionin e tyre në melodi dhe ushtrime;
- ekzekutimin e ushtrimeve melodike në instrument;
- bashkëpunimin gjatë plotësimit të detyrës, vetëm ose në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të punojnë me ushtrimet e paraqitura në tekst me shkallët muzikore.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re (shkallët muzikore D- Dur dhe h – mol; G-dur dhe e-mol).

28

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Këndon këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar tekniken e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup).	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal. I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë. I.3. Interpreton individualisht ose në grup.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: Këngë "You are the World"			
Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim			
Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore **Nxënësi/ja:** - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion; - respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve; - ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Artet Përdorimi i ngjyrave për të ngjyrosur ose skicuar një përjetim emocional nga muzika e këngës.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësimi fillon me një veprimtari **bisedë**, duke u kërkuar atyre të flasin për ritmin dhe melodinë e këngës.
Nxënësit flasin për njohuritë e tyre muzikore dhe gjuhësore duke diskutuar me njëri-tjetrin.

Ndërtimi i njohurive të reja
Vazhdohet puna me mësimin e këngës "You are the World", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

- Dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd.
- Procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- Demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- Këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit.
- Mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- Mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- Interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- Përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave.*
- Përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuar atë me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

- I -
There comes a time when we heed a certain call
When the world must come together as one
There are people dying
And it's time to lend a hand to life
The greatest gift of all

- II -
We can't go on pretending day by day
That someone, somewhere will soon make a change
We all are a part of God's great big family
And the truth, you know,
Love is all we need

- Refreni -
We are the world, we are the children
We are the ones who make a brighter day So let's start giving
There's a choice we're making
We're saving our own lives
It's true we'll make a better day
Just you and me

- III -
Send them your heart so they'll know that someone cares
And their lives will be stronger and free As God has shown us by turning stone to bread
So we all must lend a helping hand

Demonstrimi i rezultateve të arritura
Nxënësit:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth këngëtarit të njohur Michael Jackson;
- thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi
Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
- Komunikimin qartë të njohurive muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;
- Këndimin duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- Interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- Respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve/shoqeve;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

29

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** "Krijues dhe performues"		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Dallon nëpërmjet dëgjimit apo shfaqjes koncertale dallojnë muzikën skenike, koret dhe orkestrën. - Njohin vepra artistike dhe krijues artistë të shquar dhe krijimtari popullore dhe artistike kombëtare dhe botërore të periudhave të ndryshme.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Përfaqësues dhe vepra muzikore"			
Fjalët kyçe: çmuarje, krijim, përkryerje artistike			
Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore **Nxënësi/ja:** - identifikon përfaqësues dhe interpretues të muzikës botërore përmes dëgjimit; - shpjegon veprat dhe instrumentet muzikore që interpretuesit luajnë në shfaqje të ndryshme muzikore; - shfaq parapëlqimin e vet për instrumentin që i pëlqen më shumë, duke dëgjuar dhe argumentuar shembuj të ndryshëm muzikore të ndryshëm; - sjell informacione për krijuesit dhe interpretuesit më të njohur të muzikës botërore; - respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve. - ndan njohuritë e veta me të tjerët.			
Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.			
Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore: Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko dhe kulturore.			

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete (**brainstorming**), përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave nga interpretues dhe kompozitorë të ndryshëm botërore. Vendosen CD me fragmente muzikore që luhen me instrumente, të cilat nxënësit i identifikojnë. Ata flasin rreth njohurive që kanë për këto lloj instrumentesh.



Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej,me një **teknikë "Harta e të pyeturit"** ku mësimdhënësi paraqet emrat ose fotot e kompozitorëve, nëpërmjet një posteri ose një projektori dhe u kërkon nxënësve/eve t'i identifikojnë ato sipas njohurive që ata kanë.

Vazhdohet me vendosjen e disa fotove nga kompozitorë të ndryshëm të mëdhenj të muzikës botërore dhe interpretues botërore: Shopen, Smetana, Shubert dhe Çajkovski.
Nxiten nxënësit të flasin rreth tyre me informacionin që kanë dhe njohuritë që marrin nëpërmjet librit të tyre të muzikës.



Nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, *YouTube*, nxënësit/et sjellin kuriozitete rreth krijuesve, interpretuesve dhe përfaqësuesve që kanë:
- shkruar për këto instrumente;
- kanë luajtur në këto instrumente.

dhe kanë zhvilluar më tej këto instrumente muzikore duke I diskutuar punët e tyre me shokët.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi veprimtarinë muzikore të kompozitorëve botërore nëpërmjet teknikës **Diagrami i Venit** ku vendosen dy vepra muzikore të baletit nga Çajkovski për të gjetur emrin e kompozitorit.



Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- dëgjimin e fragmenteve muzikore nga përfaqësues të muzikës botërore;
- shpjegimin e veprave që dëgjon duke thënë disa karakteristika të veprës muzikore që dëgjon;
- grumbullimin dhe prurjen në klasë me CD/DVD të pjesëve instrumentale, sipas klasifikimit të veprave nga përfaqësues të parapëlqyer;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë **interpretime nga repertori i kompozitorëve të ndryshëm botërore** përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

30

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore

Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** "Krijues dhe performues"		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Njohin vepra artistike dhe krijues artistë të shquar dhe krijimtari popullore dhe artistike kombëtare dhe botërore të periudhave të ndryshme.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: "Performues shqiptarë dhe kosovarë"

Fjalët kyçe: interpretim, performim, përkryerje artistike

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- identifikon interpretues të muzikës shqiptare përmes dëgjimit;
- shpjegon veprat dhe instrumentet muzikore që interpretuesit luajnë në shfaqje të ndryshme muzikore;
- shfaq parapëlqimin e vet për performimin vokal apo instrumental që i pëlqen më shumë, duke dëgjuar dhe argumentuar atë;
- kërkon informacione për interpretuesit më të njohur shqiptare dhe kosovarë;
- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve.
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet
Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko dhe kulturore.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete (**brainstorming)**, paraqet, nëpërmjet një posteri ose një projektori foto të interpretuesve të ndryshëm shqiptarë dhe kosovarë dhe u kërkon nxënësve/eve t'i identifikojnë ato sipas njohurive që kanë.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, ku mësimdhënësi përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, gjatë 20-30 sekondave nga interpretues vokalë apo instrumentale shqiptarë dhe kosovarë. Vendosen CD me fragmente muzikore që ata interpretojnë, të cilat nxënësit i identifikojnë.

Nëpërmjet hulumtimeve që kanë bërë në internet, *YouTube*, nxënësit/et sjellin kuriozitete rreth krijuesve, interpretuesve dhe përfaqësuesve që kanë ekzekutuar dhe interpretuar dhe kanë zhvilluar më tej këtë gjini duke diskutuar veprimtarinë e tyre artistike me shokët.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi instrumentet muzikore nëpërmjet teknikës **Diagrami i Venit** ku vendosen dy interpretues të operës: Sajmir Pirgu dhe Ramë Lahaj dhe ajo që i bashkon ata është kombësia shqiptare.



Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- identifikimin e interpretuesve të muzikës shqiptare përmes dëgjimit;
- shpjegimin e interpretimit e lojës artistike që bëjnë ata në në shfaqje të ndryshme muzikore;
- argumentimin e parapëlqimit të vet për performimin vokal apo instrumental që i pëlqen më shumë;
- gjetjen dhe prezantimin e informacionit për interpretuesit më të njohur shqiptare dhe kosovarë;
- respektimin dhe vlerësimin e mendimit të shokëve/shoqeve.
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë **interpretime nga repertori i performuesve të ndryshëm shqiptarë** përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

31

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - këndon këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar tekniken e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup).	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.
I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.
I.3. Interpreton individualisht ose në grup.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Këngë "Urim për mësuesen time"

Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngën me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Artet
Përdorimi i ngjyrave për të ngjyrosur ose skicuar një përjetim emocional nga muzika e këngës.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësimi fillon me një veprimtari **bisedë**, duke u kërkuar atyre të flasin për ritmin dhe melodinë e këngës.
Nxënësit flasin për njohuritë e tyre muzikore dhe gjuhësore duke diskutuar me njëri-tjetrin.

Ndërtimi i njohurive të reja

Vazhdohet puna me mësimin e këngës "Urim mësueses", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.
- Dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd.
- Procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- Demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar këngën.
- Këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit.
- Mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- Mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- Interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- Përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i të gjitha strofave.*
- Përkryerja artistike e këngës: Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.

- I -
Një sekret që ma ka zemra, ma tradhtoi, ma nxori kënga.
Pse kaq fort këtë mëngjes po troket?
Më ngacmojn' qindra mendime, sot për fest' mësueses sime,
Çfar' dhurate t'i dhuroj?
- II -
O krijes' qiellore, dashuri p'rrallore,
zëri yt i ëmbël melodi më dhuron.
O mësuese e dashur, shpirti yt i pasur, në çdo thinj' një brez i tër' jeton.
- Refreni -
Sot gëzim fëmijë çelet në çdo an', kemi fest', kërcejm' edhe këndojm'.
Lule t'buk'ra zemrat çelin anemban' dhe për fest' mësueses ia dhurojm'.

Nxënësit mundohen ta këndojnë, duke e mësuara të me vargje, strofë, duke e përsëritur të gjithë këngën disa herë deri në përvetësimin e mirë të saj. Ata këndojnë vetëm ose në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin e këngës në ritëm dhe intonacion.

Demonstrimi i rezultateve të arritura
Nxënësit:
- diskutojnë me njëri-tjetrin rreth Festës së mësuesit;
- thonë pse iu pëlqen kjo këngë.

Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në: - komunikimin qartë të njohurive muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon; - këndimin duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara; - interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion; - respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve/shoqeve; - bashkëpunimin dhe këndimin në grup për realizimin e detyrës (këngës).
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të këngës) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

32

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** "Gjinitë, llojet muzikore"		**Rezultati i të nxënit të temës:** përmes dëgjimit muzikor dallojnë dhe krahasojnë muzikën vokale, instrumentale, vokalo-instrumentale dhe muzikën skenike përmes shembujve muzikorë nga krijimtaria muzikore botërore dhe kombëtare.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi I informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara): 1.2. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Muzika skenike"			
Fjalët kyçe: operetta, opera, baleti, mjuzikëll			

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- identifikon gjinitë muzikore që bëjnë pjesë në muzikën skenike nga më e vogla deri tek ato më të mëdhatë;
- identifikon përmes dëgjimit *muzikën vokale për gjininë e operës* përmes veprave të kompozitorëve shqiptarë dhe botërore;
- shpjegon emocionet e përjetuara për një nga veprat skenike që ka parë: operetta, opera, baleti, mjuzikëll;
- kërkon dhe prezanton dy vepra skenike muzikore: balet, opera, operetë apo mjuzikëll, përmes mediave të ndryshme (DVD, CD, magnetofon);
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Artet, gjuha dhe letërsia
Përdorimi i koncepteve në jetën e përditshme mbi muzikën skenike.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situate ndërvepruese përmes **bisedës**, duke nxitur nxënësit të flasin rreth një vepre skenike që ata kanë parë.
Nxënësit diskutojnë duke dëgjuar mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Njohuritë e reja fillojnë me shpjegimin e muzikës skenike, të veçantat dhe të përbashkëtat e tyre. operetta, opera, baleti, mjuzikëlli.
Vendosen për dëgjim disa vepra skenike vokale dhe kërcimore:
Dëgjimi 1: Opereta “Karnavalet”
Dëgjimi 2:Opera “Mrika”
Dëgjimi 3: Baleti :Cuca e maleve”
Dëgjimi 4: mjuzikëll “Grease”

Nxiten nxënësit të të flasin për përjetimet e tyre mbi muzikën skenike duke u ndalur edhe në përmbajtjen dhe muzikën që ato kanë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi dy format muzikore vokale përmes teknikës së Diagramit të Venit.



Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- shpjegimin çka ata dinë lidhur me muzikën skenike: opera, baleti, operetta, mjuzikëll;
- shpjegimin e elementeve që e përbëjnë një vepër të përmasave skenike duke i renditur ato;
- identifikimin e veprave të ndryshme përmes dëgjimit të kompozitorëve shqiptarë dhe botërore;
- ndarjen e emocioneve të përjetuara për një nga veprat muzikore skenike që ka ndjekur;
- kërkimin dhe prezantimin e dy veprave muzikore vokale: kantatë dhe oratori, përmes mediave të ndryshme (DVD, CD, magnetofon);
- bashkëpunimin duke ndarë njohuritë e veta me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë në veprën e tyre të parapëlqyer dhe krijojnë një punim të vetin.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

33

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** Nxënësit këndojnë këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar tekniken e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup).	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave positive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke trasmentuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.
I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.
I.3. Interpreton individualisht ose në grup.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Këngë "Ti më dhe zërin e bilbilit"

Fjalët kyçe: Tekst i këngës, melodi, interpretim

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:
- - komunikon qartë njohuritë muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton këngët me ndjenjë dhe emocion;
- respekton interpretimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Gjuhët dhe komunikimi: letërsia, shkenca.
Përdorimi në jetën e përditshme i koncepteve dele, të mira materiale dhe ushqimore, etj

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësuesi/ja nxit përmes shkrimit të fjalëve apo paraqitjes së fotografive/posterave të ndryshëm në lidhje me qytetin e Gjakovës: Nxënësve u kërkohet që të flasin për emocionet që përcjell arti i *fjalës* dhe i *melodisë*. Diskutimet ndihmojnë që ata të kuptojnë vetë se sa të rëndësishme janë simbolet e një kombi.
Ndërtimi i njohurive të reja
Vazhdohet puna me mësimin e këngës "Ti më dhe zërin e bilbilit", duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.

Vendoset për dëgjim kënga dhe bëhet:
- dëgjimi i vijës melodike të këngës në Cd
- Procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga kënga).
- Demonstrimi i këngës nga mësimdhënësi dhe krijimi i gadishmërisë për tëmësuar këngën.
- Këndimi i këngës sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit.
- Mësimi i melodisë së këngës me rrokje neutral.
- Mësimi i frazave të melodisë së këngës me solmizim.
- Interpretimi dhe ndjekja e ritmit të këngës në partiturë.
- Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- Përvetësimi i këngës: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha, këndimi i te gjitha strofave*
- Përkryerja artistike e këngës: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Gjatë mësimit të këngës, tregohet kujdes për respektimin *e ritmit, të intonacionit dhe të interpretimit* të këngës.

- I -
A thue drita e mëngjezit
Rrezja e par' kur zgjohet në agim,
A thue gemi i trëndafilit
Të qëndisi ty qyteti im.
- II -
Perëndimet t'i përflakën,
Ata trima që për ty kan' rën',
Duke mbjell aq lule gjaku,
Emrin ty Gjakovë ta kan' vën'.

- Refreni -
Ti më dhe zën' e bilbilit,
Gurgullimën e një kroi,
Ti më fale freskin' e prillit,
Që gjith' jetën un' ty të këndoj.

- III -
Edhe lulet e pranverës
Bukuri e rrallë për çdo prag,
Sa her' shkrepën vetëtimat
U spërkatën dhe u lan' me gjak.
- IV -
Ai gjak që rrjedh në emër
Dhe që rrënjët thellë t'i vadit,
Qarkullon këtu në zemër
Dhe më bën të quhem biri yt.
- Refreni -
Ti më dhe zën' e bilbilit...

Vlerësimi
Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
- komunikimin qartë të njohurive muzikore, duke i lidhur ato me emocionet e këngëve që këndon;
- këndimin duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpretimin e këngës me ndjenjë dhe emocion;
- respektimin e interpretimit dhe performimit të shokëve/shoqeve;
- bashkëpunimin dhe këndimin në grup.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të vijës melodike) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

34

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** **Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës:** **III**	**Klasa: VII** **(shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Interpretim në instrumente		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Luan individualisht dhe në grup, pjesë instrumentale, me dhe pa tekst notal si dhe shoqërojnë këndimin me instrumente muzikore që përdorin.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.9. Inicimi i veprimeve konstruktive gjatë lojës muzikore.
II.3. Kupton, ndjek udhëzimet për të realizuar një krijim apo veprimtari muzikore.
II.7. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.1. Kompetenca të raporteve ndërpersonale. Ndërkulturore dhe shoqërore.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I.2.3. Krijon melodi, ritme, këngë e shoqërime instrumentale të këngëve.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Luajmë në instrument

Fjalët kyçe: rregullat e luajtjes në instrument, ritëm, melodi

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- luan pjesë të ndryshme me dy instrumente, duke respektuar simbolikat e mësuara në muzikë;
- luan në instrument, duke respektuar rregullat e ekzekutimit;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, instrumenti muzikor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësimi fillon me një veprimtari **(bisedë)** me nxënësit, duke iu kërkuar atyre të rikujtojnë rregullat e luajtjes në instrument dhe bërë nxehjen me të.
Ndërtimi i njohurive të reja
Vazhdohet puna me mësimin luajtjes me dy instrumente muzikore të ushtrimeve apo pjesëve muzikore që ka në tekst.
Demonstrohet nga mësimdhënësi pastaj nga nxënësit ushtrimi nga më i thjeshti te më i vështiri.
Më pas vazhdohet ekzekutimi nga vetë nxënësit në grupe, duke u ushtruar.



Vlerësimi Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në: - demonstrimin me korrektësi të luajtjes së ushtrimeve muzikore në instrumentin muzikor; - ekzekutimin korrekt të notave muzikore sipas intervaleve në fyell/bllokflaut, duke respektuar rregullat e luajtjes; - bashkëpunimin dhe respektimin e ritmit dhe intonacionit gjatë luajtjes së ushtrimeve me fyell/ bllokflaut).
Detyrat dhe puna e pavarur
Udhëzohen nxënësit për **përsëritjen e** ushtrimeve të tekstit në shtëpi.
Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore
Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

35

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda:** **Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës:** **III**	**Klasa: VII** **(shtatë)**
Konceptet: Çmuarja dhe vlerësimi estetik dhe artistik **Tema:** "Vepra dhe ngjarje muzikore"		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Komenton ngjarje të ndryshme artistike kombëtare, dhe botërore. - Marrin pjesë në aktivitet të ndryshme brenda dhe jashtë shkollës dhe vlerësojnë ato.	
Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara): I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike. I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim. II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi. III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme. III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive. IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon. V.2. Dëshmim i vetëbesimit. VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.			
Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : 1.5. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.			
Aspektet specifike të planit të orës mësimore			
Njësia mësimore: "Veprimtari muzikore artistike"			
Fjalët kyçe: festival folklorik, festival i muzikës së lehtë, festival i këngës, festivali këngës për fëmijë			

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- identifikon llojin e aktiviteteve muzikore duke i përcaktuar ato;
- merr pjesë në koncerte apo aktivitet muzikor të muzikës për fëmijë, së lehtë, xhaz, popullore etj., kombëtare dhe botërore;
- grumbullon material për aktivitete muzikore shqiptare, kosovare apo botërore;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Ora mësimore zhvillohet nëpërmjet krijimit të një situate ndërvepruese përmes **brainstorming (foto/postera/filmime)**, ku mësimdhënësi nxit nxënësit të flasin në lidhje me aktivitetet muzikore brenda dhe jashtë vendit kua ata kanë marrë pjesë apo kanë parë. Nxënësit diskutojnë në lidhje me të të dhe dëgjojnë mendimin e njëri-tjetrit.

Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)

Më pas jepen informacione në lidhje me aktivitetet muzikore të kryera në Kosovë dhe Shqipëri.

Ata zgjerojnë më shumë diskutimin lidhur me:
- aktivitetin;
- organizatorët;
- rëndësinë;
- pjesëmarrësit etj.

Nxënësit nxiten për kërkimin dhe gjetjen e informacioneve shtesë mbi aktivitetet muzikore që ju kanë lënë mbresa nga *interneti,* dhe sjellin prezantimin e tyre në klasë.

Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi aktivitetet muzikore përmes diagramit të Venit.



Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:
- shpjegimin e llojeve të aktiviteteve muzikore;
- aktivizimin dhe marrjen pjesë në koncerte apo aktivitet muzikor të muzikës për fëmijë, së lehtë, xhaz, popullore etj., kombëtare dhe botërore;
- gjetjen dhe prezantimin e materialeve për aktivitetet muzikore shqiptare, kosovare apo botërore;
- ndarjen e njohurive të veta me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të flasin rreth aktivitetit muzikor të parapëlqyer dhe krijojnë një punim të vetin bazuar në përjetimin emocional që merr kur shkon në këtë lloj aktiviteti.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

36

Aspektet e përgjithshme të planit të orës mësimore			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Krijimtaria dhe performanca artistike **Tema:** Këngë		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Këndon këngë e melodi të thjeshta në zhanre të ndryshme me ritëm dhe intonacion të saktë sipas imitimit dhe me tekst notal (së paku 6-8 këngë) duke respektuar tekniken e këndimit të drejtë e të bukur (individualisht dhe në grup).	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
I.1. Këndon dhe/ose interpreton në instrumente muzikore, këngë dhe melodi të thjeshta sipas imitimit dhe me tekst notal.
I.2. Improvizon në mënyrë kreative mbi melodi e ritme të njohura më parë.
I.3. Interpreton individualisht ose në grup.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: Kanon

Fjalët kyçe: Tekst i kanonit, melodi, interpretim

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore
Nxënësi/ja:
- komunikon qartë njohuritë muzikore, që ka për kanonin;
- këndon duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpreton kanonin duke respektuar elementet muzikore në të;
- respekton interpretimin dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Artet
Përdorimi i ngjyrave për të ngjyrosur ose skicuar një përjetim emocional nga muzika e këngës.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve
Mësimi fillon me një veprimtari **bisedë**, duke u kërkuar atyre të flasin për kanonin, veçoritë e tij.

Ndërtimi i njohurive të reja
Vazhdohet puna me mësimin e kanonit duke u mbështetur në stilin dëgjimor të të nxënit.
- Dëgjimi i vijës melodike në Cd.
- Procedura metodike - ushtrime zhvillimi të zërit (motive nga vija melodike).
- Demonstrimi i kanonit nga mësimdhënësi dhe krijimi i gatishmërisë për të mësuar atë.
- Këndimi i melodisë sipas melodisë që dëgjojnë nga Cd – me vesh nga nxënësit.
- Mësimi i melodisë me rrokje neutral.
- Mësimi i frazave të melodisë me solmizim.
- Interpretimi dhe ndjekja e ritmit në partiturë.
- Këndimi i lartësive tonale dhe vendosja e tyre me gjatësi ritmike në pentagram.
- Përvetësimi i melodisë: *Përsëritja e frazave, lidhja e tyre në tërësi më të mëdha.*
- Përkryerja artistike: *Këndimi me gjallëri emocionale, shqiptimi i qartë, tempi përkatës, ngjyrimi dinamik, shoqërimi instrumental.*

Nxënësit këndojnë në grup për të parë sa mirë e kanë mësuar melodinë dhe tekstin, në ritëm dhe intonacion.



Demonstrimi i rezultateve të arritura
Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin rreth kësaj opere dhe njohuritë që ata kanë rreth saj.

Vlerësimi
Vlerësimi i nxënësit do të kryhet për demonstrimin e aftësive të nxënësve në:
- komunikimin qartë të njohurive muzikore, që ka për kanonin;
- këndimin duke respektuar teknikën e këndimit përmes rregullave të përcaktuara;
- interpretimin e kanonit duke respektuar elementet muzikore në të;
- respektimin e interpretimit dhe performimin e shokëve/shoqeve;
- ndan përvojën e vet artistike me të tjerët.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit për **dëgjimin** (disa herë të vijës melodike) përshkrimin e përjetimit të tekstit dhe melodisë së saj.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

37

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE			
Fusha kurrikulare: Arte	**Lënda: Art muzikor**	**Shkalla e kurrikulës: III**	**Klasa: VII (shtatë)**
Konceptet: Muzika dhe shoqëria **Tema:** "Krijues dhe performues"		**Rezultati i të nxënit të temës:** - Njohin vepra artistike dhe krijuese, artistë të shquar nga krijimtari popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.	

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):
I.3. Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike.
I.8. Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim.
II.7 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi.
III.4. Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë të pavarur, efektive dhe të përgjegjshme.
III.5. Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.
IV.1. Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmetuar zotësitë që posedon.
V.2. Dëshmim i vetëbesimit.
VI.4. Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara):
3.1. Identifikon dhe emërton vepra artistike dhe krijues, artistë të shquar nga krijimtaria popullore dhe artistike kombëtare e botërore të periudhave të ndryshme.

Aspektet specifike të planit të orës mësimore

Njësia mësimore: "Të njohim kompozitorët tanë"

Fjalët kyçe: interpretim, performim, përkryerje artistike

Rezultati/et e të nxënit për orën mësimore
Nxënësi/ja:
- identifikon përfaqësues të muzikës shqiptare përmes dëgjimit;
- prezanton disa nga veprat instrumentale dhe vokale të kompozitorëve shqiptarë;
- shfaq parapëlqimin e vet për muzikën e kompozitorit të parapëlqyer, duke argumentuar veprën e tij/saj muzikore;
- sjell informacione për krijuesit dhe përfaqësuesit më të njohur të muzikës shqiptare;
- respekton dhe vlerëson mendimin e shokëve/shoqeve;
- ndan njohuritë e veta me të tjerët.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Teksti nxënësit, Art muzikor 7, Cd, mjete të tjera për të punuar.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:
Fusha: Shkencat dhe mjedisi; artet
Përcaktimi i njohurive nga lëndët e tjera dhe ndërthurja e tyre me konceptet e marra nga njohuritë muzikore për ngjarje në situata dhe kontekste të ndryshme historiko dhe kulturore.

Përshkrimi i metodologjisë dhe veprimtaritë e punës me nxënës gjatë orës mësimore:

Lidhja e temës me njohuritë e mëparshme të nxënësve - (5 minuta)
Mësimi fillon me një veprimtari konkrete (**brainstorming)** , përmes dëgjimit të disa fragmenteve muzikore, nga kompozitorë shqiptarë/gjatë 20-30 sekondave. Vendosen CD me fragmente muzikore shqiptare . Ata/ato flasin rreth njohurive që kanë këta kompozitorë.



Ndërtimi i njohurive të reja - (30 minuta)
Veprimtaria mësimore vazhdon më tej, me një **teknikë**
Harta e të pyeturit ku mësimdhënësi paraqet lloje të ndryshme disa emra të kompozitorëve shqiptarë, nëpërmjet



një posteri ose një projektori dhe u kërkon nxënësve/eve t'i identifikojnë ata duke folur për atë që njohin më mirë.
Vazhdohet me dëgjimin e fragmenteve muzikore dhe nxënësit arrijnë të krahasojnë stilin dhe përmbajtjen emocionale të vepra muzikore të krijuar nga kompozitorëve shqiptarë.
Prezantimi dhe demonstrimi i rezultateve të arritura: (10 minuta)
Përsëritin njohuritë e marra mbi veprimtarinë e kompozitorëve shqiptarë, çfarë i dallon dhe ajo që i bashkon ata.
Përgjigjet mund të jenë të ndryshme:

- Stili muzikor
- Biografia
- Format muzikore që ka kompozuar

Vlerësimi i nxënësve:
Është demonstrim i rezultateve të arritura të nxënësve në:

- dëgjimin e fragmenteve muzikore instrumentale, duke bërë listuar përfaqësuesit shqiptarë krijues që kanë dhënë kontributin e tyre;
- shpjegimin e veprave që dëgjon duke thënë pse i pëlqen muzika apo interpretimi muzikor;
- grumbullimin dhe prurjen në klasë me CD/DVD të pjesëve muzikore shqiptare;
- bashkëpunimin në grup për realizimin e detyrave.

Detyrat dhe puna e pavarur

Udhëzohen nxënësit të dëgjojnë **interpretime nga repertori i krijuesve të ndryshëm shqiptarë dhe kosovarë** përdorimin e mediave (DVD, CD, magnetofon), grumbullojnë ato dhe prezantojnë punën e vet.

Reflektimi për rrjedhën e orës mësimore

Diskutimet që ata bëjnë duke lidhur njohuritë e tyre me temën e re.

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

37.016:004(072)

Hala, Majlinda

Libër për mësuesin : art muzikor 7 / : Majlinda Hala Violeta Shamku. - Prishtinë : Botime Pegi, 2019. - 106 f. : me il. ; 20.7 x 28 cm.

1. Shamku, Violeta

ISBN 978-9951-786-01-0

Lejohet për botim me vendimin e Ministrisë
së Arsimit të Shkencës dhe të Teknologjisë,
nr. 313/01-B, të datës 16.07.2019.